



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET VENDORE

14 maj 2023

Raporti Përfundimtar

i

Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve



Varshavë
29 shtator 2023

PËRMBAJTJA

I.	PËRMbledhje Ekzekutive	1
II.	Hyrije dhe Falënderime	4
III.	Sfondi dhe Konteksti Politik	5
IV.	Kuadri Ligjor dhe Sistemi Zgjedhor	5
V.	Administrata Zgjedhore	7
VI.	Regjistrimi i Zgjedhësve	10
VII.	Regjistrimi i Kandidatëve	13
VIII.	Fushata Zgjedhore	15
IX.	Financimi i Fushatës	18
X.	Media	19
	A. Mjedisi i medias	19
	B. Kuadri ligjor.....	21
	C. Gjetjet e monitorimit të medias.....	23
XI.	Zgjidhja e mosmarrëveshjeve Zgjedhore	23
XII.	Vëzhgimi i Zgjedhjeve	25
XIII.	Dita e Zgjedhjeve	26
	A. Hapja dhe votimi	26
	B. Mbyllja dhe numërimi	28
	C. Tabulimi dhe shpallja e rezultateve	29
XIV.	Rekomandime	29
	A. Rekomandime parësore	30
	B. Rekomandime të tjera	31
	Shtojca I: Rezultatet e Zgjedhjeve	33
	Shtojca II: Lista e Vëzhguesve të Misionit Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve	35
	Rreth Odihr-it	39

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET VENDORE
14 maj 2023

Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Pas një ftese për të vëzhguar zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) krijoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 6 prill. MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e proceseve zgjedhore me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Për ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e ODIHR-it bashkoi forcat me delegacionet e Parlamentit Evropian (PE) dhe Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi) për të formuar një Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ).

Në Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake të lëshuar më 15 maj, MNVZ-ja arriti në përfundimin se zgjedhjet “në përgjithësi ishin të administruara mirë, konkurruese dhe u zhvilluan me pjesëmarrjen e forcave kryesore politike, por procesi u karakterizua nga polarizimi i vazhdueshëm ndërmjet partive kryesore politike dhe ndasisë së thellë brenda opozitës. Garuesit mund të zhvillonin fushatë lirisht, por çështjet me rëndësi për komunitetet vendore pothuajse nuk u përfshinë fare në fushatë. Rastet e keqpërdorimit të burimeve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, pretendimet për presion mbi punonjësit e sektorit publik dhe zgjedhësit dhe pretendimet për blerje votash ishin shqetësuese. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) e organizoi punën e tij në mënyrë transparente dhe efikase, por qëndrueshmëria e komisioneve të nivelit të ulët u ndikua negativisht nga zëvendësimet e shpeshta të anëtarëve nga partitë propozuese. Rregullat për mbulimin politik të fushatës në media favorizuan fuqimisht partitë kryesore dhe përdorimi i shpeshtë nga media i përmbajtjeve të përgatitura nga partitë në programet e lajmeve dëmtoi mbulimin gjithëpërfshirës dhe objektiv të fushatës. Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht paqësore, por u ndikua negativisht nga raste të shumta të ndërhyrjeve të partive në proces, si dhe nga problemet teknike dhe procedurale, votimi në grup i përhapur gjerësisht dhe problemet me fshehtësinë e votës. Numërimi i votave u vlerësua në përgjithësi pozitivisht.”

Kuadri ligjor për zgjedhjet ofron një bazë të kënaqshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Megjithatë, disa kufizime të të drejtave të votës mbeten në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe disa dispozita të Kodit Zgjedhor nuk janë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare. Në vitin 2020, autoritetet trajtuan një sërë rekomandimesh të mëparshme të ODIHR-it, por shumë të tjera mbeten ende për t'u zbatuar, duke përfshirë ato që lidhen me përbërjen e komisioneve zgjedhore të nivelit të ulët, mekanizmin për tërheqjen e kandidatëve, përgjegjësinë penale për shpifje dhe të drejtat e barabarta të vëzhguesve partiakë dhe qytetarë. Kryetarët e bashkive dhe këshilltarët bashkiakë zgjidhen drejtpërdrejt për një mandat katërvjeçar. Kryetarët e bashkive zgjidhen me shumicë të thjeshtë votash, kurse anëtarët e këshillave bashkiakë sipas një sistemi proporcional me lista të mbyllura.

Zgjedhjet në përgjithësi u menaxhuan mirë nga administrata zgjedhore, megjithëse emërimi i komisioneve të nivelit të ulët qe problematik. KQZ-ja e organizoi punën e saj në mënyrë transparente dhe efikase, duke zhvilluar seanca të rregullta dhe të hapura. Pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehu besim tek KQZ-ja dhe vuri në dukje transparencën e shtuar në vendimmarrje. Partitë politike që kishin të drejtën për të pasur anëtarë në komisionet zgjedhore të

¹ Versioni në anglisht i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Një përkthim jozyrtar është i disponueshëm në gjuhën shqipe.

niveleve më të ulëta, e përdorën lirisht këtë të drejtë për të tërhequr anëtarët e tyre në komisione, duke ndikuar në qëndrueshmërinë e këtyre komisioneve, duke zbehur vlerën e trajnimeve dhe duke mos lejuar respektimin konsekuent të procedurave të ditës së zgjedhjeve. Në këtë drejtim, partitë politike nuk arritën të përmbushnin të drejtat dhe përgjegjësitë e konsiderueshme që u jep Kodi Zgjedhor.

Listat përfundimtare të zgjedhësve përfshinin rreth 3.6 milionë zgjedhës me të drejtë vote, duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të zgjedhësve që jetojnë jashtë vendit. Në përgjithësi, bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në saktësinë e listave të zgjedhësve, por kufizimet e të drejtës së votës për shkak të aftësisë së kufizuar intelektuale dhe psikosociale janë në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet ndërkombëtare. Në ditën e zgjedhjeve, zgjedhësit u identifikuan përmes pajisjeve elektronike të identifikimit të cilat, në shumicën e rasteve, funksionuan siç duhet, por një numër i madh problemesh teknike krijuan konfuzion për stafin e qendrave të votimit dhe për zgjedhësit.

Regjistrimi i kandidatëve ishte në përgjithësi gjithëpërfshirës dhe në zgjedhje morën pjesë 40 parti dhe koalicione, si dhe 12 kandidatë të pavarur, me gjithsej 144 kandidatë për kryebashkiakë dhe 852 lista kandidatësh për këshillat bashkiakë. Kufizimet ekzistuese të së drejtës së personave, që nuk janë shpallur fajtor për kryerjen e një veprë penale me një vendim të formës së prerë të gjykatës, janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Kandidatët e pavarur u përballën me kritere më të vështira se partitë gjatë mbledhjes së nënshkrimeve.

Liritë themelore të tubimit paqësor dhe shprehjes u respektuan në përgjithësi dhe garuesit elektoralë mundën të bënin fushatë lirisht. Zgjedhësit duhet të votonin veçmaz, për kryetarët e bashkive dhe për këshillat bashkiakë. Fushata zgjedhore, një fushatë me vizibilitet, por modeste, u përqendrua tek partitë e mëdha dhe drejtuesit e tyre në shkallë vendi dhe jo te kandidatët dhe çështjet vendore, në dëm të demokracisë vendore. Atmosfera e fushatës ishte kryesisht e moderuar, megjithatë, kishte edhe retorika konfrontuese. Rrjetet sociale u përdorën gjerësisht në fushatë.

Me ndryshimet ligjore të 2020-ës u vendosën masa të mëtejshme mbrojtëse ndaj shpërdorimit të burimeve shtetërore. Edhe pse autoritetet nuk mund të propozojnë, miratojnë apo të nxjerrin vendime për përfitime për popullatën katër muaj para ditës së zgjedhjeve, ka pasur aktivitete të shumta, si nga qeveria qendrore ashtu edhe nga administratat e ndryshme vendore, që bien ndesh me këtë rregull. Interpretimi i ngushtë dhe formalist i KQZ-së se kjo dispozitë zbatohet vetëm për zgjedhjet parlamentare, por jo për zgjedhjet vendore, nuk kontribuoi shumë në garantimin e një gare me kushte të barabarta loje. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e ministrave, megjithëse nuk kandidonin, morën pjesë dukshëm në fushatën e partisë në pushtet, pa një dallim të qartë mes aktiviteteve të tyre zyrtare dhe atyre për fushatë. Kryeministri, në disa raste, vuri rezultatet e zgjedhjeve lokale si kusht për mbështetjen e ardhshme të qeverisë qendrore për bashkitë. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it shpesh pretendonin se kishte frikësim të zgjedhësve, presione ndaj punonjësve të sektorit publik dhe blerje votash.

Nga 140 deputetë, 50 janë gra (35 për qind) dhe nga 17 ministra të qeverisë, 13 janë gra. Gratë ishin të mirëpërfaqësuar në listat e kandidatëve për shkak të një kuote gjinore parashikuar me ligj prej 50 për qind (edhe pse kuota nuk respektohej gjithmonë), por mes 144 kandidatëve për kryebashkiakë kishte vetëm 15 gra (10 për qind). Në shumicën e tubimeve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it pati kandidate gra, por vetëm 8 për qind e mbulimit të fushatës së monitoruar në media iu kushtua grave. Nuk u ngrit asnjë shqetësim për retorikën mizogjene, kërcënimet apo gjuhën e urrejtjes ndaj grave në kontekstin zgjedhor. Tetë gra që përfaqësonin që të gjitha partinë në pushtet u zgjodhën kryetare bashkie. Gratë ishin të papërfaqësuar sa duhet në administratën zgjedhore, veçanërisht në pozicionet vendimmarrëse.

Garuesit mund t'i financojnë fushatat e tyre me fonde publike dhe private, por kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtën e financimit publik, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare. Ligji

parashikon kufizime për donacionet dhe shpenzimet e fushatës. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime për mungesë transparence në financimet e fushatës përpara ditës së zgjedhjeve, pasi, deri më sot, garuesve nuk u kërkohet të paraqesin raporte të ndërmjetme për financimin e fushatës ose që të bëjnë të ditur burimin dhe sasinë e fondeve të mbledhura. Shpërndarja e vonuar e fondeve publike dhe përcaktimi i vonuar i kufijve të shpenzimeve të fushatës nuk kontribuuan në sigurinë juridike. KQZ-ja ka përgjegjësinë e mbikëqyrjes së financimit të fushatës.

Kuadri ligjor për median ofron në përgjithësi garanci për lirinë e shprehjes dhe aksesin në informacion. Megjithatë, dispozitat ligjore për aksesin në informacion nuk janë zbatuar në mënyrë të mjaftueshme. Mjedisi mediatik është i larmishëm, por karakterizohet nga probleme të sistemit, duke përfshirë përqendrimin joproporcional të pronësisë së medias dhe kontrollin e ushtruar nga interesat e ndërthurura të biznesit dhe politikës. Këto ndikojnë në autonominë editoriale të medias dhe i bëjnë gazetarët të cenueshëm ndaj presionit dhe autocensurës. Rregullat për mbulimin e fushatës nga mediat transmetuese u ofrojnë partive parlamentare kryesore një avantazh të konsiderueshëm, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Sipas rezultateve të monitorimit të medias nga MVZ-ja e ODIHR-it, fushata në media u karakterizua nga sulme personale të përsëritura ndërmjet politikanëve dhe mungesë debatesh ndërmjet garuesve. Në programet e tyre të lajmeve, transmetuesit shpesh përdornin ato që dukej të ishin materiale partiake të regjistruara paraprakisht, rrallëherë me shënimin përkatës, dhe nuk arrinin të siguronin një mbulim gjithëpërfshirës dhe objektiv të fushatës.

Kodi Zgjedhor ofron garanci të mjaftueshme procedurale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) i KQZ-së i trajtoi ankimet në mënyrë kolegjiale dhe në seanca të hapura. Megjithatë, në disa raste, mori vendime kontradiktore, duke mos krijuar një interpretim të qëndrueshëm të ligjit, ose duke i lënë paditësit pa zgjidhje juridike efektive. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dyshim paanshmërinë e anëtarëve të KAS-it për shkak të përkatësisë së tyre të pretenduar politike. Kolegji Zgjedhor, shkalla e fundit gjyqësore për mosmarrëveshjet zgjedhore, i gjykoi çështjet në seanca publike, me pjesëmarrjen e palëve të përfshira. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor ishin të arsyetuara mirë, por disa nga vendimet e tyre u publikuan me vonesa të konsiderueshme.

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor nga vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Në një proces gjithëpërfshirës, KQZ-ja akreditoi gjithsej 452 vëzhgues vendorë dhe 557 ndërkombëtarë. Për vëzhgim mund të akreditohen edhe përfaqësues të partive, koalicioneve, kandidatëve të pavarur dhe mediave. Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, të drejtën e marrjes së kopjeve të protokolleve të rezultateve të votimit e kanë vetëm vëzhguesit partiakë, por jo vëzhguesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Disa organizata të shoqërisë civile monitoruan përdorimin e burimeve administrative dhe pajtueshmërinë me rregulloret e fushatës dhe disa dërguan një numër të vogël vëzhguesish në ditën e zgjedhjeve.

Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve ishte paqësore, por u ndikua negativisht nga raste të shumta ndërhyrjesh të partive në proces, si dhe nga problemet teknike dhe procedurale. Në një numër të konsiderueshëm qendrash të vëzhguara votimi, MNVZ-ja e vlerësoi negativisht pjesën e hapjes së tyre për shkak të problemeve të konstatuara procedurale dhe teknike. Procesi i votimit u vlerësua negativisht në 7 për qind të qendrave të vëzhguara të votimit, gjë që përbën shqetësim. Procedurat e votimit në përgjithësi u respektuan, por MNVZ-ja vuri re raste të përhapura gjerësisht të votimit në grup dhe probleme me fshehtësinë e votës. MNVZ-ja konstatoi gjithashtu raste të votimit me prokurë, tensione, presion ndaj zgjedhësve dhe përpjekje për të ndikuar tek zgjedhësit. Mbyllja e qendrave të votimit dhe marrja e materialit zgjedhor në Vendet e Numërimit të Votave (VNV) u vlerësuan pozitivisht.

Numërimi i votave u vlerësua negativisht në 8 për qind të VNV-ve të vëzhguara. Procedurat përgjithësisht u respektuan, por jo gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme. Transparenca ishte e kufizuar dhe MNVZ-ja konstatoi raste të izoluara tensionesh dhe ndërhyrjesh nga aktivistët e partive. Për shkak të ngarkesës së punës dhe lodhjes fizike, Komisionet e Zonave të Administrimit të Zgjedhjeve e ndërprejnë procesin e numërimit në rreth dhjetë-dymbëdhjetë VNV të vëzhguara. KQZ-ja i publikoi menjëherë rezultatet paraprake dhe përfundimtare të zgjedhjeve të ndara sipas qendrave të votimit. Rezultatet e zgjedhjeve për kryetar bashkie në një bashki u anuluan nga Kolegji Zgjedhor dhe u përsëritën më 23 korrik.

Ky raport ofron rekomandime në mbështetje të përpjekjeve për harmonizimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor në Shqipëri me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet e standardet ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet parësore kanë të bëjnë me masat e hollësishme, në kohë dhe transparente kundër keqpërdorimit të burimeve administrative dhe shkeljeve të tjera zgjedhore, përpjekjet reale për të luftuar praktikatat e shitblerjes së votës, nevojën për një reformë zgjedhore kuptimplote për të garantuar fshehtësinë e votimit, dekriminalizimin e shpifjes, garantimin e lirisë editoriale të mediave, mbështetjen e gazetarisë së pavarur, forcimin e efektivitetit të administratës zgjedhore dhe mundësimin e aksesit të duhur në informacion. ODIHR-i mbetet i gatshëm për t'i ndihmuar autoritetet në përmirësimin e mëtejshëm të procesit zgjedhor dhe në zbatimin e rekomandimeve që përmban ky raport dhe raportet e mëparshme.

II. HYRJE DHE FALËNDERIME

Pas një ftese për të vëzhguar zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023 dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) krijoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 6 prill. Misioni, i udhëhequr nga ambasadorja Audrey Glover, përbëhej nga një ekip bazë prej 14 anëtarësh të vendosur në Tiranë dhe 24 vëzhgues afatgjatë të dërguar më 13 prill në 12 qarqe në mbarë vendin. MVZ-ja e ODIHR-it qëndroi në vend deri më 24 maj.

Për ditën e zgjedhjeve, me MVZ-në e ODIHR-it u bashkuan edhe delegacione të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës (Kongresi) dhe Parlamentit Evropian (PE) për të formuar një Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ). Secili nga institucionet e përfshira në MNVZ e ka miratuar Deklaratën e Parimeve të vitit 2005 për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve. Stewart Dikson ishte kreu i delegacionit të Kongresit dhe Sven Simon kryesonte delegacionin e PE-së. Në ditën e zgjedhjeve u angazhuan 246 vëzhgues nga 31 vende, duke përfshirë 216 vëzhgues të ODIHR-it, një delegacion prej 20 anëtarësh nga Kongresi dhe një delegacion prej 10 anëtarësh nga PE-ja. Gratë përbënin 51 për qind të vëzhguesve të MNVZ-së.

MVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Ky raport përfundimtar vjen pas një Deklarate të Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake që u publikua në një konferencë për shtyp në Tiranë më 15 maj.²

MVZ-ja e ODIHR-it dëshiron të falënderojë autoritetet e Shqipërisë për ftesën për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për ndihmën e tyre. MVZ-ja e ODIHR-it shpreh vlerësimin e saj edhe për institucionet e tjera shtetërore dhe vendore, partitë politike, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile, përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar dhe bashkëbisedues të tjerë për ndarjen e pikëpamjeve dhe për bashkëpunimin e tyre.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Shqipëria është një republikë parlamentare, ku kompetencat legislative i janë dhënë parlamentit me një dhomë, të përbërë prej 140 deputetësh të zgjedhur për mandate katërvjeçare. Qeveria e kryesuar nga kryeministri ka kompetenca të gjera ekzekutive. Presidenti është kreu i shtetit dhe zgjidhet nga parlamenti për një mandat pesë-vjeçar.

Në zgjedhjet vendore të 2019-ës, një koalicion i udhëhequr nga Partia Socialiste (PS) atëherë në pushtet fitoi 60 nga 61 bashki gjithsej.³ Partia Demokratike (PD) e opozitës, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI, që prej atëherë e ka ndryshuar emrin në Partia e Lirisë (PL)) dhe disa parti më të vogla i bojkotuan zgjedhjet. Më 6 mars 2022 u mbajtën zgjedhjet e pjesshme në gjashtë bashki, ku vendi i kryetarit të bashkisë kishte mbetur vakant.⁴

PS-ja fitoi edhe zgjedhjet parlamentare të 2021-shit, duke marrë 74 mandate në parlament.⁵ Kryetari i PS-së, Edi Rama, mbajti postin e kryeministrit për një mandat të tretë që nga viti 2013. Pas zgjedhjeve të 2021-shit dhe shpalljes publikisht si *persona non grata* të ish-kryeministrit dhe kryetarit historik të PD-së, Berisha, nga qeveria e Shteteve të Bashkuara, PD-ja pësoi përçarje të brendshme, duke përfshirë një mosmarrëveshje për përfaqësimin e saj ligjor.⁶

Në përgjithësi, mjedisi politik vazhdoi të karakterizohej nga dominimi i elitave politike tradicionale dhe polarizimi i thellë ndërmjet partive kryesore, i manifestuar edhe nga një ngërç për reformën zgjedhore në periudhën 2021-2023. Për më tepër, PS-ja gëzonte avantazhin e të qenit në pushtet në të gjithë sektorët e jetës publike, gjë që e akumuluar përgjatë dekadës së fundit, u pa nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it si një faktor që mund të ndikonte në parimin e ndarjes së pushteteve.

Në qeverinë aktuale, nga 17 ministra, 13 janë gra.⁷ Nga 140 deputetë, 50 janë gra (35 për qind), duke përfshirë edhe Kryetaren e Kuvendit. Shumica e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Kolegjit Zgjedhor janë gjithashtu gra.

IV. KUADRI LIGJOR DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet vendore rregullohen kryesisht nga Kushtetuta dhe Kodi Zgjedhor (të dyja të ndryshuara për herë të fundit në vitin 2020).⁸ Legjislacioni dytësor përfshin Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për

³ Kryetar i bashkisë së Finiqit u zgjodh kandidati i partisë Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen (MEGA).

⁴ Zgjedhjet e pjesshme u zhvilluan në Dibër, Durrës, Lushnjë, Rrogozhinë, Shkodër dhe Vorë. Partia Demokratike e Shqipërisë-Komisioni i Rithemelimit (PDKR) i drejtuar nga Sali Berisha, i cili kandidoi nën siglën e koalicionit Shtëpia e Lirisë, fitoi në Shkodër, ndërsa PS-ja mbajti pesë postet e tjera të kryebashkiakut.

⁵ Aleanca për Ndryshim e udhëhequr nga PD-ja fitoi 59 mandate, LSI-ja 4 dhe Partia Socialdemokrate (PSD) 3.

⁶ Pas humbjes së PD-së në zgjedhjet e pjesshme për kryetarët e bashkive në mars të vitit 2022, Lulzim Basha dha dorëheqjen si kryetar partie dhe Enkelejd Alibeaj u bë ushtrues i detyrës së kryetarit të PD-së. Më 25 mars 2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë regjistroi ndryshimet statutores të miratuara nga një Konventë Kombëtare e PD-së dhe më 22 maj, z. Berisha u zgjodh kryetar partie. Në datën 3 mars 2023, pas ankimit të z. Alibeaj, disa ditë përpara afatit për paraqitjen e listave të kandidatëve, Gjykata e Apelit Tiranë e shfuqizoi vendimin në fjalë të datës 25 mars 2022 dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim, duke ia lënë përfaqësimin ligjor të partisë z. Alibeaj. Gjykata e publikoi këtë vendim vetëm më 11 maj, pavarësisht nga kërkesa ligjore për ta bërë këtë brenda dy javësh. Më 15 maj, PDKR-ja e ankoi këtë vendim në Gjykatën e Lartë.

⁷ Në nëntor të vitit 2022, Raportuesi i Posaçëm i OKB-së për të drejtën e zhvillimit [i lavdëroi](#) përpjekjet e qeverisë shqiptare për të siguruar pjesëmarrjen e grave në organet qeverisëse dhe vendimmarrëse, duke përfshirë qeverinë qendrore dhe shërbimin civil.

⁸ Ligji për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare parashikon të drejta të plota politike, civile dhe shoqërore për njerëzit që u përkasin pakicave kombëtare. Janë nëntë pakica kombëtare të njohura zyrtarisht: pakicat arumune, boshnjake, bullgare, egjiptiane, greke, maqedonase, malazeze, rome dhe serbe.

Tubimet, Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Garantimin e Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrijnë Funksione Publike (i ashtuquajtur Ligji për Dekriminalizimin), si dhe rregulloret e nxjerra nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Shqipëria është palë e instrumenteve kryesore ndërkombëtare që lidhen me zgjedhjet demokratike dhe anëtare e Komisionit për Demokraci përmes Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venecias) dhe e Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).⁹

Kuadri ligjor zgjedhor është një bazë e kënaqshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, por përmban kufizime të të drejtës së votës, të cilat janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, si dhe disa mospërputhje dhe paqartësi të shkaktuara nga ndryshimet ligjore të vitit 2020.¹⁰ Kodi Zgjedhor është i përshtatur kryesisht për zgjedhjet parlamentare dhe për këtë arsye, në disa raste, i mungon qartësia për zgjedhjet vendore, duke cenuar sigurinë juridike.¹¹ Disa ligje, për shembull Ligji për Dekriminalizimin që ka të bëjë me kufizimet e të drejtës së votës, duhet të harmonizohen me Kodin Zgjedhor për të garantuar qëndrueshmëri.¹² Përveç kësaj, disa dispozita që lidhen me administratën zgjedhore, regjistrimin e kandidatëve, financimin e fushatës dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore nuk janë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Dispozitat e miratuara me ndryshimet ligjore të vitit 2020 trajtuan disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it, duke përfshirë ato për masa mbrojtëse ndaj keqpërdorimit të burimeve administrative dhe për garanci të përforcuara për ekuilibrin gjinor në listat e kandidatëve. Megjithatë, mosrregullimi i fushatave nga palë të treta dhe paqartësitë në dispozitat që kanë për qëllim frenimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore për fushatë krijojnë boshllëqe që kufizojnë zbatimin konsistent dhe gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor.

Interpretimi i ngushtë i ligjit ishte i dukshëm në disa vendime të KQZ-së, duke e bërë edhe më të paqartë se si duhet të zbatohen disa dispozita (shih pjesën *Fushata Zgjedhore*). Miratimi me vonesë dhe publikimi i vonuar i disa akteve detyruese e kufizoi transparencën e procesit zgjedhor dhe e zvogëloi mundësinë e palëve të interesuara dhe zgjedhësve për t'u njohur menjëherë me rregullat, në kundërshtim me praktikën e mirë.¹³

Aktet nënligjore që rregullojnë procesin zgjedhor duhet të miratohen në kohën e duhur për të garantuar siguri juridike, përgatitje efektive dhe njohjen e tyre nga publiku.

Shumë rekomandime të mëparshme të ODIHR-it mbeten të pazbatuara, duke përfshirë ato që lidhen me përbërjen e komisioneve zgjedhore të niveleve të ulëta, mekanizmin për tërheqjen e kandidatëve,

⁹ Duke përfshirë [Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike](#) të vitit 1966 (ICCPR), [Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor](#) të vitit 1965, [Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave](#) të vitit 1979 (CEDAW), [Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre](#) të vitit 1990, [Konventën e OKB-së kundër Korrupsionit](#) të vitit 2003, [Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara](#) të vitit 2006 (CRPD), si dhe [Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#) të vitit 1950 dhe [Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare](#) të vitit 1998.

¹⁰ Për shembull, Neni 145.2 i Kodit Zgjedhor i referohet versionit më të vjetër të Nenit 24, i cili u shfuqizua me ndryshimet e korrikut të vitit 2020. Kufizimi i së drejtës së votimit të personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose psikosociale u hoq nga Neni 44, por mbeti në Kushtetutë (Neni 45) dhe në Nenin 53 të Kodit Zgjedhor.

¹¹ Për shembull, Neni 91.4 i Kodit Zgjedhor përcakton një ndalim katërmujor, përpara ditës së zgjedhjeve dhe deri në formimin e një qeverie të re, gjatë së cilës autoritetet nuk mund të propozojnë ose të nxjerrin vendime që ofrojnë përfitime për popullatën. Mungesa e qartësisë nëse ky nen zbatohet për zgjedhjet vendore çoi në zbatimin e tij në mënyrë jokonsistente.

¹² Ligji për Dekriminalizimin përmban kufizime të së drejtës së votës dhe dispozita të detajuara për çregjistrimin e kandidatës, por në Kodin Zgjedhor nuk ka dispozita të tilla. Gjithashtu, Ligji për Dekriminalizimin nuk përmban dispozita për të drejtën e ankimit të vendimeve të KQZ-së siç parashikohet në Kodin Zgjedhor.

¹³ Për shembull, vendimi i KQZ-së i 22 prillit për përcaktimin e shumës së fondeve publike për aktivitetet e fushatës dhe vendimi i parlamentit i 26 prillit për shpërndarjen e fondeve për fushatën për partitë politike.

të drejtat e votimit të personave me aftësi të kufizuara intelektuale ose psikosociale, përgjegjësinë penale për shpifje, përdorimin e materialeve të fushatës të përgatitura nga partitë politike në lajme dhe të drejtat e barabarta të vëzhguesve partiakë dhe qytetarë. Në shkurt të vitit 2022, parlamenti ngriti një komision *ad hoc* për reformën zgjedhore për zbatimin e rekomandimeve të pazbatuara të ODIHR-it. Në tetor të vitit 2022, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve (Komisioneri) propozoi përditësime të Kodit Zgjedhor që lidheshin, ndër të tjera, me funksionimin e komisioneve zgjedhore të niveleve të ulëta, financimin e fushatave zgjedhore dhe aktivitetet e zyrtarëve publikë gjatë fushatës. Megjithatë, komisioni *ad hoc* nuk propozoi ndonjë ndryshim përpara zgjedhjeve.

Për të garantuar një kuadër zgjedhor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të gjitha subjektet vendimmarrëse, duke përfshirë parlamentin, partitë politike parlamentare dhe palët e tjera të interesuara zgjedhore, duhet të angazhohen për një reformë zgjedhore kuptimplotë dhe për zbatimin e të gjitha rekomandimeve të ODIHR-it.

Zgjedhjet e drejtpërdrejta u mbajtën për 61 kryetarë bashkie dhe 1,613 anëtarë të këshillave bashkiakë në të gjithë vendin për mandate katërvjeçare. Kryetarët e bashkive zgjidhen në gara me shumicë të thjeshtë vote, ndërsa anëtarët e këshillave bashkiakë sipas një sistemi proporcional me lista të mbyllura.¹⁴ Zonat elektorale për zgjedhjet vendore janë territoret e bashkive dhe numri i këshilltarëve në secilën bashki varion nga 15 deri në 61, në varësi të popullsisë. Për ndarjen e vendeve në këshillat bashkiakë nuk ka asnjë prag kualifikimi.¹⁵

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet u administruan nga KQZ-ja, 92 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5,213 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV).¹⁶ Numërimi u zhvillua në 92 Vende të Numërimit të Votave (VNV). Të gjitha komisionet e nivelit të ulët janë organe të përkohshme. Gratë ishin të nënpërfaqësuar në të gjithë administratën zgjedhore, veçanërisht në pozitat vendimmarrëse. Megjithëse Kodi Zgjedhor parashikon një kuotë gjinore prej 30 për qind në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore, vetëm 3 nga 12 anëtarët e KQZ-së janë gra, duke përfshirë edhe nënkomisioneren. Rreth 29 për qind e anëtarëve të KZAZ-ve ishin gra, duke përfshirë 16 nga 92 kryetarët. Gratë përbënin 24 për qind të anëtarëve të KQV-ve (23 për qind të kryetarëve të KQV-ve) në qendrat e votimit të vëzhguara nga MNVZ-ja.

KQZ-ja përbëhet nga tre organe drejtuese: Komisioneri dhe Nënkomisioneri, Komisioni Rregullator (Rregullatori) dhe Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS). KQZ-ja është përgjegjëse për mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe anëtarët e saj zgjidhen nga parlamenti me një shumicë prej jo më pak se tre të pestat e votave.¹⁷

Komisioneri drejton administratën e KQZ-së dhe ushtron kompetenca ekzekutive. Nënkomisioneri mbikëqyr zbatimin e teknologjisë elektronike të identifikimit të zgjedhësve dhe rekrutimin dhe trajnimin e zyrtarëve zgjedhorë. Rregullatori, në kuadër të kompetencave të deleguara nga Kodi Zgjedhor, vendos rregulla për aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor. KAS-i gjykon ankimimet ndaj Komisionerit dhe KZAZ-ve, si dhe vendos sanksione lidhur me zgjedhjet.

¹⁴ Mandatet e këshillave vendorë iu ndahen partive dhe koalicioneve sipas metodës d'Hondt. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it nga partitë më të vogla politike dhe organizatat e shoqërisë civile shprehën një preferencë për përfaqësim proporcional me lista të hapura.

¹⁵ Në vendimin e saj nr. 31, datë 4 tetor 2021, Gjykata Kushtetuese vendosi se pragu 1 për qind për kandidatët individualë është i papajtueshëm me Kushtetutën.

¹⁶ Dy qendra të posaçme votimi në burgjet e Tepelenës dhe të Belshit u miratuan nga KQZ-ja përkatësisht në datat 8 dhe 12 maj.

¹⁷ Komisioneri zgjidhet për shtatë vjet, nënkomisioneri për katër vjet, pesë anëtarët e Rregullatorit për pesë vjet dhe pesë anëtarët e KAS-it për nëntë vjet.

Në përgjithësi, KQZ-ja ka funksionuar me efikasitet dhe e ka respektuar shumicën e afateve ligjore.¹⁸ Komisioneri miratoi rreth 550 vendime lidhur me regjistrimin e kandidatëve, raportet për keqpërdorimin e burimeve administrative, përgatitjen e ditës së zgjedhjeve dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve dhe miratimin e rezultateve të zgjedhjeve. Komisioneri, Rregullatori dhe KAS-i mbajtën veçmas seanca të rregullta dhe të hapura që u transmetuan drejtpërdrejt në internet. MVZ-ja e ODIHR-it vuri re se ndërhyrjet e përfaqësuesve të partive në seancat e KQZ-së nuk ishin gjithmonë në dobi të përgatitjeve për zgjedhje.¹⁹ Vendimet e KQZ-së zakonisht publikohen në faqen e saj të internetit. Megjithatë, MVZ-ja e ODIHR-it vërejti vonesa në shpalljen e seancave dhe publikimin e vendimeve nga të treja organet, gjë që e kufizoi transparencën.²⁰ Megjithëse pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR shprehën besim tek KQZ-ja dhe theksuan se kishte transparencë dhe akses të shtuar në vendimmarrjen e saj, disa prej tyre vunë në pikëpyetje paanshmërinë e KAS-it (shihni pjesën mbi *Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve Zgjedhore*).

KZAZ-të mbikëqyrin zgjedhjet në zonat e tyre përkatëse. Ato përbëhen nga shtatë anëtarë dhe një sekretar pa të drejtë vote, i propozuar nga shumica parlamentare dhe opozita.²¹ KQV-të organizojnë votimin dhe kanë të njëjtën përbërje si KZAZ-të.²² Grupet e numërimit përbëhen nga katër anëtarë, të cilët gjithashtu emërohen nga shumica parlamentare dhe opozita.

Formimi i administratës zgjedhore të nivelit të ulët pati probleme kryesisht për shkak të mosemërimit të përfaqësuesve të disa partive që e kishin këtë të drejtë. Deri në afatin ligjor të datës 12 shkurt, KQZ-ja formoi KZAZ-të me vetëm katër ose pesë anëtarë dhe shpesh pa sekretar. Sipas ligjit, për formimin e KZAZ-ve, KQZ-ja mund të kërkonte edhe aplikime nga qytetarët që plotësonin kushtet për të qenë pjesë e tyre. Megjithatë, përpara se të emëronte anëtarët e KZAZ-së të emëruar nga PD-ja, ajo priti vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë për mosmarrëveshjen për përfaqësimin ligjor të PD-së. Në 84 KZAZ, anëtarët e emëruar nga PD-ja u emëruan me një muaj vonesë.²³ Po kështu, KQV-të duhet të formoheshin deri më 24 prill, por për shkak të vonesave të emërimeve dhe mungesës së dokumenteve, shumica e KQV-ve u formuan me më shumë se një javë vonesë. Grupet e numërimit duhej të emëroheshin deri më 4 maj, por vendimi i Komisionerit për palët që kishin të drejtë të emëronin anëtarët e grupit të numërimit u ankimua, gjë që çoi në formimin e tyre me vonesë.²⁴

Në kundërshtim me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe praktikat e mira ndërkombëtare, partitë politike, sipas vlerësimit të tyre dhe pa arsyetim, mund t'i tërheqin ose zëvendësojnë anëtarët

¹⁸ MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje disa vonesa në ndarjen e kohës së transmetimit falas për subjektet zgjedhore, në përcaktimin e renditjes së kandidatëve në fletëvotim, në emërimin e KZAZ-së, KQV-së dhe anëtarëve të grupeve të numërimit, si dhe në publikimin e listave të zgjedhësve.

¹⁹ Për shembull, vendimi se cilat parti kishin të drejtë të emëronin anëtarë të grupit të numërimit u shty të paktën katër here për shkak të kërkesave të përfaqësuesve të partive, të cilat çuan në emërime të vonuara.

²⁰ Në disa raste, KQZ-ja i publikoi vendimet me një javë ose më shumë vonesë. Disa seanca nuk u njoftuan paraprakisht. Gjithashtu, për shkak të transferimit të faqes së internetit në një server të sigurt, KQZ-ja nuk mundi të publikonte njoftimet apo vendimet në kohën e duhur deri më 6 maj.

²¹ Për këto zgjedhje, KZAZ-të përbëheshin nga 2 anëtarë të propozuar nga PS-ja, 2 nga PD-ja, 1 nga PSD-ja dhe 1 nga PL-ja. Në KZAZ-të me numra çift, anëtari i shtatë u propozua nga PS-ja, ndërsa në ato tek nga PD-ja. Kryetari i përket partisë që ka emëruar anëtarin e shtatë, ndërsa nënkryetari dhe sekretari përfaqësojnë përkatësisht partinë më të madhe opozitare ose mazhorancën.

²² Ndryshe nga KZAZ-të, KQV-të nuk kanë sekretar pa të drejtë vote.

²³ Pas vendimit të gjykatës, më 10 mars u emëruan 217 anëtarë të KZAZ-së të propozuar nga PD-ja dhe 33 anëtarë të KZAZ-së më 21 mars. Këtu përfshihej edhe emërimi me vonesë i sekretarëve në 42 KZAZ. Në disa raste, vendet vakante të sekretarëve plotësoheshin nga PL-ja.

²⁴ Në një rast ankimi nga PL-ja të vendimit të Komisionerit, KAS-i nuk arriti të merrte një vendim për shkak të një barazimi votash më 2 maj. Pas shqyrtimit të Kolegjit Zgjedhor, KAS-i e hodhi poshtë ankesën e PL-së më 10 maj.

e tyre të komisionit, duke ndikuar kështu në qëndrueshmërinë e administratës zgjedhore.²⁵ Midis 12 shkurtit dhe ditës së zgjedhjeve, rreth 40 për qind e anëtarëve të KZAZ-ve u zëvendësuan, si dhe të paktën 30 për qind e anëtarëve të KQV-ve në katër ditët e fundit para ditës së zgjedhjeve. Në disa zona, grupet e numërimit nuk u formuan dhe nuk u trajnuan deri në fund të votimit në ditën e zgjedhjeve për shkak të mungesës së dokumentacionit, tërheqjeve apo dorëheqjeve. Disa parti e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kishin në plan t'i zëvendësonin të gjithë anëtarët e tyre të KQV-ve që ata të mos ishin objekt i presioneve apo ryshfeteve nga kundërshtarët e tyre. Prandaj, shumë nga emërimet fillestare të partive dukeshin false. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it deklaruan gjithashtu se komisionet e nivelit të ulët mbetën të cenueshme nga presioni politik dhe ende nuk e gëzonin besimin e plotë të palëve të interesuara.

Zëvendësimet e shumta të anëtarëve të komisioneve të nivelit të ulët nuk lejuan zhvillimin e trajnimeve thelbësore dhe respektimin konsistent të procedurave të ditës së zgjedhjeve.²⁶ Në përgjithësi, MVZ-ja e ODIHR-it i vlerësoi seancat e trajnimit të organizuara për komisionerët zgjedhorë si gjithëpërfshirëse, edhe pse në disa raste, pjesëmarrja ishte e vogël dhe cilësia varej nga njohuritë dhe qasja e trajnerëve.²⁷ Sipas KQZ-së, komunikimi i saj me komisionet e niveleve të ulëta ishte problematik herë pas here, duke ndikuar negativisht në aftësinë e administratës zgjedhore për t'i organizuar zgjedhjet në mënyrë të qëndrueshme.

Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e administratës zgjedhore, duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të sistemit të emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të administratës zgjedhore të nivelit të ulët. Duhet të merren masa për të ndaluar zëvendësimet arbitrare të anëtarëve të administratës zgjedhore.

Megjithëse ligji kërkon që qendrat e votimit të vendosen në ambiente të aksesueshme, 60 për qind e qendrave të votimit të vizituara nga MNVZ-ja në ditën e zgjedhjeve nuk ishin lehtësisht të aksesueshme për zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike.²⁸ Përveç kësaj, anëtarët e KQV-ve nuk ishin plotësisht të informuar se pse shërbenin shabllonet Braille me të cilat ishin pajisur qendrat e votimit dhe jo kudo kishte kabina votimi të përshtatura për nevojat e personave me aftësi të kufizuara fizike. Pajisjet e votimit të përdorura në projektin pilot të votimit elektronik nuk u përshtatën për përdorim të pavarur nga personat me probleme me shikimin. KQZ-ja zhvilloi një fushatë të gjerë për edukimin e zgjedhësve, duke përfshirë edhe fushatën në gjuhët e tetë pakicave kombëtare dhe në gjuhën e shenjave.²⁹ Megjithatë, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dukje se nuk kishte materiale lehtësisht të lexueshme për edukimin e zgjedhësve dhe se përpjekjet komunikuese të KQZ-së nuk arritën deri në qarqe apo te grupet vulnerabël si zgjedhësit në zona të largëta, pakicat kombëtare dhe personat me aftësi të kufizuara.

Administrata zgjedhore, partitë politike dhe shoqëria civile duhet të përpiqen t'i përmirësojnë më tej programet për edukimin e zgjedhësve, veçanërisht në nivel qarku. Mund t'i kushtohet vëmendje përshtatjes së iniciativave për nevojat e pakicave kombëtare, veçanërisht romëve dhe egjiptianëve, dhe zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

²⁵ Seksioni II.3.1.f i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) të Komisionit të Venecias të vitit 2002 thekson se "organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lira t'i shkarkojnë ata sipas dëshirës".

²⁶ Për të trajtuar zëvendësimet e shumta, KQZ-ja zhvilloi trajnime shtesë për anëtarët e KZAZ-ve. KQZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se vetëm 27 për qind e anëtarëve të KQV-së ishin trajnuar.

²⁷ MVZ-ja e ODIHR-it vërejti pjesëmarrje të ulët ose mungesë paraqitjeje gjatë seancave trajnuese në qarqet e Beratit, Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Lezhës dhe Tiranës.

²⁸ Neni 29(a) i [CRPD-së](#) i detyron Shtetet të garantojnë që "procedurat, pajisjet dhe materialet e votimit të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të lehta për t'u kuptuar dhe përdorur". Shihni gjithashtu paragrafin 34 të [Komentit të Përgjithshëm nr. 1 të Nenit 12 të CRPD-së](#).

²⁹ Posterat dhe videot për identifikimin e zgjedhësve dhe krimet elektorale u prodhuan gjithashtu në gjuhët e pakicave.

Votimi elektronik pilot u zhvillua në 401 qendrat e votimit të bashkive Elbasan, Kamëz dhe Vorë, duke përfshirë 310,846 zgjedhës të regjistruar.³⁰ Ky ishte projekti i tretë pilot i organizuar nga KQZ-ja që nga viti 2021, duke përfshirë një numër më të madh bashkish dhe rreth 8 për qind të të gjitha qendrave të votimit. KQZ-ja siguroi edhe 760 pajisje elektronike të tjera votimi, duke arritur në 828 pajisje gjithsej të përdorura në kuadrin e projektit pilot të vitit 2023.

Në zonën pilot, zgjedhësit votuan duke përdorur pajisjet e votimit dhe numërimit të pajisura me një ekran me prekje (pajisje elektronike me regjistrim të drejtpërdrejtë) të lidhura me printera ku procesi i votimit lë gjurmë për qëllime auditimi, asnjëri prej të cilëve nuk ishte i lidhur me internetin. Zgjedhësit mund ta verifikonin votën e tyre në një fletë letre të printuar nga pajisja. Më 18 prill, KQZ-ja filloi simulimet në të treja bashkitë dhe një fushatë në internet për edukimin e zgjedhësve, e cila vazhdoi deri në ditën e zgjedhjeve.³¹ Më 4 maj, në përputhje me ligjin, KQZ-ja organizoi edhe testimin publik të 3 për qind të pajisjeve. Miratimi i vonuar i fondeve nga parlamenti dhe dorëzimi i shumicës së pajisjeve të votimit vetëm dy muaj përpara ditës së zgjedhjeve nuk e mundësoi edukimin thelbësor të zgjedhësve dhe shtrirjen e gjerë në zona të largëta.³² Nuk u krye asnjë kontroll përpara zgjedhjeve apo certifikim i pajisjeve dhe softuerit, në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare.³³

Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, burime të mjaftueshme duhet të shpërndahen paraprakisht për të garantuar përgatitje efektive dhe monitorim të pavarur dhe kuptimplotë nga ana e publikut të teknologjive zgjedhore.

Në ditën e zgjedhjeve, MNVZ-ja vuri re se zgjedhësit kërkonin më shumë udhëzime dhe ndihmë për ndjekjen e procedurave të votimit në pajisjet e votimit. Në një numër të konsiderueshëm rastesh të vëzhguara, kjo vinte në rrezik fshehtësinë e votës.

Autoritetet duhet t'i njohin më mirë zgjedhësit me teknologjitë zgjedhore dhe të ofrojnë akses të barabartë në procesin e votimit. Duhet të merren masa për t'u mundësuar zgjedhësve që përdorin teknologji të reja të votojnë në mënyrë të pavarur dhe në fshehtësi të plotë.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Të drejtë vote kanë shtetasit e moshës 18 vjeç e lart në ditën e zgjedhjeve, me përjashtim të atyre që me vendim gjykatë konstatohen të paafte për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale dhe psikosociale, gjë që është në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin

³⁰ Çdo qendër votimi ishte e pajisur me dy aparate votimi. Fletët e votimit ishin në dispozicion në KZAZ-ve si rezervë në rast të mosfunksionimit të pajisjeve.

³¹ Ndërsa demonstrimi i aparateve të votimit elektronik i ndihmoi zgjedhësit të njiheshin me mënyrën e re të votimit, zonat e thella rurale nuk kishin akses të barabartë në këto prezantime. Pajisjet demonstruese nuk ishin të pajisura me letrën për printimin e fletës, gjë që nuk iu mundësonte zgjedhësve të simulonin të gjitha fazat e procesit të votimit.

³² Fondet u ndanë nga qeveria në fund të janarit të vitit 2023, dhe tenderi u mbyll në mes të marsit.

³³ [Udhëzimet për zbatimin e dispozitave të Rekomandimit CM/Rec\(2017\)5 për standardet e votimit elektronik](#) të Këshillit të Evropës theksojnë se “Aksesi i publikut në komponentët e sistemit të votimit elektronik dhe në informacionin rreth tij, në veçanti rreth dokumentacioni, kodit burimor dhe marrëveshjet për mosnxjerrje të informacioneve, duhet t’u bëhen të ditura palëve të interesuara dhe publikut në përgjithësi shumë përpara periudhës zgjedhore”. Përveç kësaj, Seksioni 95 thotë se “Vlerësimi që sistemet e votimit elektronik funksionojnë në mënyrë korrekte dhe se ruhet siguria është thelbësor. Mjeti për ta arritur këtë është vlerësimi ose certifikimi i pavarur i sistemit në tërësi ose i komponentëve të tij, i cili kërkon zbulimin e elementeve kritike të sistemit”.

për shkak të aftësive të kufizuara.³⁴ E drejta e votës u pezullohet edhe shtetasve që vuajnë dënimin me burg për kryerjen e veprave të caktuara penale.³⁵

Për të garantuar të drejtën universale të votës dhe trajtim të barabartë përpara ligjit, duhet të hiqen kufizimet për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale dhe psikosociale.

Regjistrimi i zgjedhësve bëhet në mënyrë pasive. Listat e zgjedhësve nxirren nga Regjistri i Përhershëm Kombëtar i Gjendjes Civile dhe mbahen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) pranë Ministrisë së Brendshme (MB). Zgjedhësit mbi 100 vjeç u hoqën automatikisht nga lista dhe u duhej të konfirmonin të dhënat e tyre që t'u viheshin emrat sërish në listë.³⁶ Zgjedhësit mund t'i kontrollonin të dhënat e tyre në regjister dhe të kërkonin korrigjime deri më 4 prill.³⁷ Më pas, deri në 24 orë përpara ditës së zgjedhjeve, zgjedhësit mund të kërkonin ndryshime në të dhënat e tyre duke iu drejtuar gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës.³⁸ Listat përfundimtare të zgjedhësve përmbanin 3,650,658 zgjedhës, duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të zgjedhësve që jetonin jashtë vendit, në veçanti shtetas në moshë të re.³⁹ Listat e zgjedhësve u afishuan në qendrat e votimit dhe garuesit mund të kërkonin kopje të tyre për qëllime të fushatës. Ndonjëherë, listat e zgjedhësve nuk ishin të disponueshme publikisht në qendrat e votimit, gjë që mund të kufizonte kontrollin publik të listave të zgjedhësve në ato zona.⁴⁰

KQZ-ja mbikëqyri procesin e hartimit të listës së zgjedhësve. Dy auditues të emëruar nga KQZ-ja në nëntor të vitit 2020 vlerësuan saktësinë e listave të zgjedhësve dhe nuk e vunë në dyshim përgjithësisht saktësinë e tyre.⁴¹ Pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, MB-ja nxori një udhëzim ku përshkruhej metodologjia dhe hapat kyç për shqyrtimin e listave zgjedhore. Ekstrakti i parë nga ekstraktet e dala çdo gjashtë muaj u publikua më 22 nëntor 2022, kurse i fundit më 4 prill. Gjatë kësaj periudhe, kryetarët e bashkive përkatëse, në bashkërendim me zyrat vendore të gjendjes civile, duhej të garantonin që numri i zgjedhësve të regjistruar për qendër votimi të ishte brenda kufijve të

³⁴ Neni 29 i [CRPD-së](#) kërkon nga Shtetet Palë që "t'u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t'i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët". Shihni gjithashtu paragrafin 48 të [Komentit të Përgjithshëm nr. 1 të Nenit 12 të CRPD-së](#). Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës](#) të vitit 1990 parashikon që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së do të "garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë të votës për qytetarët madhorë".

³⁵ Ligji për Dekriminalizimin e pezullon të drejtën e votës për kryerjen e krimeve të renditura në më shumë se 80 nene të Kodit Penal (duke filluar nga veprat e lidhura me zgjedhjet deri te krimet e rënda).

³⁶ Paragrafi 5.9 i [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës](#) të vitit 1990 parashikon: "Të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtjen e barabartë të ligjit". Shihni gjithashtu Nenin 26 të [ICCPR-së](#). Sipas MB-së, nga 3,717 zgjedhës mbi 100 vjeç, 3,589 janë hequr nga regjistri i zgjedhësve dhe 128 kanë mbetur në listën përfundimtare të zgjedhësve.

³⁷ Zgjedhësit mund t'i kontrollojnë të dhënat e tyre duke përdorur faqen e internetit të KQZ-së ose portalin në internet në e-albania.al. Vetëm 237 zgjedhës kërkuar korrigjime të vogla, dhe 34,184 e ndryshuan vendndodhjen e qendrës së votimit për shkak të ndryshimit të vendbanimit.

³⁸ KQZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se 454 zgjedhës u shtuan në listat e zgjedhësve në bazë të vendimeve gjyqësore, pas informacionit të dërguar nga Drejtoria e Burgjeve për burgjet në Belsh, Kukës, Lezhë, Tepelenë, Tiranë dhe Vlorë. KQZ-ja i miratoi të gjitha kërkesat, përveç atyre të Kukësit, të cilat mbërritën shumë vonë. Gjithsej 108 zgjedhës u shtuan në listat e zgjedhësve pas krijimit të dy qendrave shtesë të votimit.

³⁹ Në Shqipëri nuk ka votime nga jashtë vendit. Sipas një [raporti](#) të vitit 2020 të Institutit Shqiptar të Statistikave (në shqip), rreth 1.6 milionë shtetas shqiptarë jetojnë jashtë vendit. KQZ-ja përllongariti në konferencat e saj publike se rreth 40 përqind e zgjedhësve banojnë jashtë vendit. Listat përfundimtare të zgjedhësve përfshinin 1,843,278 burra dhe 1,807,380 gra.

⁴⁰ Në Cërrik, në disa zona të qarkut Kukës, në Shkodër dhe në Tiranë, MVZ-ja e ODIHR-it vërejti se listat e zgjedhësve nuk ishin afishuar në kohë. Në Kukës dhe në disa zona të thella të qarkut të Elbasanit, listat e zgjedhësve u dëmtuan ose u hoqën ose u afishuan në një mënyrë që nuk lejonte kontrollin nga publiku.

⁴¹ Audituesit u propozuan nga PD-ja dhe PS-ja.

përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.⁴² Më 19 janar, pak para publikimit të ekstraktit të tretë, MB-ja e ndryshoi udhëzimin fillestar, duke specifikuar edhe disa kritere shtesë për caktimin e zgjedhësve në qendrat e votimit sipas kodit të ndërtesës dhe sipas rendit alfabetik, duke marrë për bazë mbiemrin.⁴³

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën përgjithësisht besim në saktësinë e listave të zgjedhësve, por MVZ-ja e ODIHR-it vërejti mospërputhje në shpërndarjen e njoftimeve për zgjedhësit nga autoritetet vendore.⁴⁴ Njoftimet për zgjedhësit nuk pasqyronin ndryshimet që rezultuan nga ricaktimi i zgjedhësve në qendra të ndryshme votimi dhe vetëm 40 bashki raportuan në KQZ se kishin shpërndarë njoftime më vonë gjatë procesit.

Autoritetet duhet t'i informojnë të gjithë zgjedhësit për vendndodhjen e qendrave përkatëse të votimit dhe t'i afishojnë vazhdimisht listat e zgjedhësve në të gjitha bashkitë. Duhet të shihet mundësia që afati i njoftimit të zgjedhësve të jetë më afër ditës së zgjedhjeve.

Zgjedhësit u identifikuan në ditën e zgjedhjeve përmes pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) që punonin pa internet. Këto pajisje përmbanin listat e zgjedhësve të të gjitha qendrave të votimit. Zgjedhësit paraqisnin letërnjoftimet ose pasaportat biometrike për verifikimin e identitetit dhe për të konfirmuar identifikimin, u skanoheshin edhe gjurmët e gishtërinjve.⁴⁵ Pas identifikimit me sukses, KQV-të printonin dhe mbanin një fletë me të dhënat personale dhe një foto për verifikime paszgjedhore. Rekrutimi i operatorëve teknikë për identifikimin e zgjedhësve ishte një sfidë për administratën zgjedhore në disa zona dhe KQZ-së iu desh ta trajnonte stafin më afër ditës së zgjedhjeve. MVZ-ja e ODIHR-it i vlerësoi pozitivisht seancat e trajnimit të vëzhguara. Më 5 maj, KQZ-ja organizoi testimin publik të 3 për qind të PEI-ve, por nuk u krye asnjë auditim i pavarur i pajisjeve dhe softuerit.⁴⁶ Në ditën e zgjedhjeve, PEI-t nuk u përdorën në rreth 580 qendra votimi (11 për qind e të gjitha qendrave të votimit) për shkak të problemeve teknike, mungesës së operatorëve teknikë dhe njohjes së kufizuar të disa procedurave që lidhen me mirëmbajtjen e pajisjeve. Megjithëse në shumicën e rasteve PEI-t funksionuan siç duhet, përqindja e lartë e problemeve teknike krijuan konfuzion për shumë anëtarë të KQV-ve.

Mund t'i kushtohet vëmendje rekrutimit dhe trajnimit të operatorëve teknikë përgjegjës për identifikimin elektronik të zgjedhësve në kohën e duhur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrë në konsideratë kryerjen e një auditimi të pavarur të pajisjeve dhe softuerit përpara ditës së zgjedhjeve.

⁴² Kryetarët e bashkive duhej t'i gruponin zgjedhësit sipas kufijve të qendrave të votimit të përdorura në zgjedhjet e mëparshme, duke garantuar që qendrat e votimit të kishin jo më pak se 300 dhe jo më shumë se 1000 zgjedhës të regjistruar. Në rast të dështimit të një kryetari bashkie, DPGJC-ja mund t'i ndajë zgjedhësit në qendrat e votimit.

⁴³ Më parë, zgjedhësit grupoheshin në rend alfabetik sipas mbiemrit.

⁴⁴ Kryetarët e bashkive duhej t'u dërgonin zgjedhësve njoftime për vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit jo më vonë se data 21 janar.

⁴⁵ KQZ-ja prezantoi kritere të reja për identifikimin e zgjedhësve për të parandaluar përpjekjet e mundshme për votim në vend të dikujt tjetër. Zgjedhësit kishin deri në tre përpjekje për ta skanuar gishtin e madh dhe gishtin tregues për t'u identifikuar. Nëse kjo dështonte, zgjedhësit duhet ta nënshkruanin listën e zgjedhësve dhe printimin nga pajisja për t'u lejuar të votonin. Sipas MB-së, ishin rreth 271,000 zgjedhës me letërnjoftime të skaduara. Në prill, qeveria e zgjati vlefshmërinë e letërnjoftimeve të skaduara për qëllime votimi, për të garantuar pjesëmarrjen e zgjedhësve të prekur.

⁴⁶ Seksionet 7 dhe 8 të [Udhëzuesve të Këshillit të Evropës për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit \(TIK\) në proceset zgjedhore të vitit 2022](#) përcaktojnë një vlerësim të pavarur dhe transparencë të produkteve të TIK-ut.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote ka të drejtë të kandidojë, përveç atyre, detyrat e të cilëve janë të papajtueshme me kandidimin, ata që vuajnë dënimin me burg ose që kanë qenë të dënuar më parë për kategori të caktuara veprash penale ose që janë në kërkim.⁴⁷ Kufizimet e së drejtës së kandidimit për qytetarët, fajësia e të cilëve për kryerjen e një krimi nuk është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, janë në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe standardet ndërkombëtare.⁴⁸

Kufizimet e së drejtës së kandidimit të personave, fajësia e të cilëve për kryerjen e një krimi nuk është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, duhet të hiqen.

KQZ-ja regjistroi 38 parti dhe 2 koalicione si subjekte zgjedhore që kishin të drejtën të dilnin me kandidatë.⁴⁹ Kandidatët e pavarur mund të propozoheshin nga grupe prej së paku nëntë zgjedhësish me banim në bashkinë përkatëse. Çdo grup duhej të regjistrohej nga KZAZ-ja ose KQZ-ja përkatëse. Subjektet zgjedhore dhe grupet e zgjedhësve duhet t'i dorëzonin listat e kandidatëve ose propozimet e tyre në KZAZ-të përkatëse ose në KQZ jo më vonë se data 25 mars.⁵⁰

Partitë dhe grupet e zgjedhësve që nuk kishin përfaqësim në parlament, në këshillat vendorë apo kryetarë bashkie për një periudhë prej të paktën gjashtë muajsh duhej të dorëzonin nënshkrimet mbështetëse të jo më pak se 1 për qind të zgjedhësve nga bashkia përkatëse. Ligji e kufizon numrin maksimal të nënshkrimeve mbështetëse të nevojshme në 3,000 për partitë politike, por jo për kandidatët e pavarur, duke e bërë kështu më të vështirë procesin e regjistrimit për këta të fundit, veçanërisht në Tiranë dhe Durrës.⁵¹ Vetëm katër nga tetë partitë që duhej të dorëzonin nënshkrime i mblodhën ato.⁵²

Disa parti hasën vështirësi në regjistrim.⁵³ Disa parti më të vogla politike i konsideruan më sfiduese se duhet kërkesat për dokumentacionin në mbështetje të listave të kandidatëve.⁵⁴

⁴⁷ Ligji për Dekriminalizimin i referohet dëbimit nga një shtet anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai gjithashtu e kufizon të drejtën për kandidim të qytetarëve të dënuar për krime të caktuara, edhe në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, si dhe për ata që janë në kërkim ndërkombëtar. Presidenti i Republikës, gjyqtarët, prokurorët, oficerët ushtarakë, policorë dhe të sigurisë kombëtare, personeli diplomatik, prefektët, anëtarët e komisioneve zgjedhore dhe zyrtarët e nivelit të lartë të administratës shtetërore, të përcaktuar me ligj, duhet të japin dorëheqjen për të pasur të drejtë të kandidojnë.

⁴⁸ Paragrafi 5.19 i [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës](#) të vitit 1990 përcakton: “Të gjithë do të prezumohen të pafajshëm derisa të provohet fajësia sipas ligjit”.

⁴⁹ Subjekt zgjedhor është një parti politike, koalicion ose kandidat i pavarur që garon në zgjedhje. Në bazë të të dhënave të KQZ-së, tre partive dhe shtatë grupeve të zgjedhësve iu është refuzuar regjistrimi për shkak të dokumentacionit të paplotë.

⁵⁰ Për këto zgjedhje, 50 nga 92 KZAZ-të e trajtuan regjistrimin e kandidatëve. Në 11 nga 61 bashki që përfshinin më shumë se një zonë të administrimit zgjedhor, kandidatët u regjistruan nga KQZ-ja.

⁵¹ Në rastin e Tiranës, numri për nënshkrimet e nevojshme për kandidatët e pavarur u përcaktua në 7,000, krahasuar me 3,000 nënshkrime në mbështetje të propozimeve të partive. Sipas paragrafit 185 të [Udhëzimeve për rregullimin e partive politike](#) të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2020, “Kandidatët e pavarur duhet [...] të lejohen të kandidojnë në zgjedhje sipas të njëjtave kushte që zbatohen për kandidatët e propozuar nga partitë politike”.

⁵² Partia Konservatore, Nisma Thurje, Lëvizja Bashkë dhe Aleanca Arbnore Kombëtare i mblodhën nënshkrimet e kërkuara. Partia Qytetare Shqiptare, Partia Shqiptare Atdheu, Aleanca Demokracia e Re dhe Partia e Personave me Aftësi të Kufizuara u regjistruan si subjekte zgjedhore por nuk mblodhën numrin e duhur të nënshkrimeve në bashkitë ku synonin të kandidonin.

⁵³ Lëvizja Bashkë, e cila doli me kandidatë për kryetar bashkie dhe këshilltarë në Tiranë, u regjistrua si parti politike nga Gjykata e Tiranës më 2 mars. Komisioneri dhe KAS-i e cilësuan vendimin e gjykatës si jo të formës së prerë dhe e refuzuan regjistrimin e partisë si subjekt zgjedhor. Në apel, Kolegji Zgjedhor e urdhëroi KQZ-në ta regjistronte Lëvizjen Bashkë si subjekt zgjedhor.

⁵⁴ Garuesit duhej të dorëzonin kopje të nënshkruara të letërnjoftimeve të zgjedhësve që i kishin nënshkruar në mbështetje të tyre.

Duhet të shihet mundësia e rishikimit të pragut të mbështetjes nga zgjedhësit për garantimin e kushteve të njëjta për t'u përmbushur nga kandidatët e pavarur dhe kandidatët e propozuar nga partitë.

Për t'u regjistruar, listat e kandidatëve për këshillat bashkiakë duhej të përfaqësonin në mënyrë të barabartë gratë dhe burrat, me alternimin në lista të kandidatëve të gjinive të ndryshme.⁵⁵ Ky kusht nuk u plotësua në shumicën e bashkive.⁵⁶ Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, në disa zona, gratë ishin më pak të gatshme për të kandiduar në zgjedhje për shkak të stereotipeve ekzistuese lidhur me rolet gjinore, ndërsa në disa raste, partitë u përballën me vështirësi në paraqitjen e numrit të kërkuar të grave kandidate. Në përgjithësi, gratë ishin të mirëpërfaqësuar në listat e kandidatëve.

Për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të grave në jetën publike dhe politike, duke përfshirë edhe zgjedhjet për kryebashkiakë, autoritetet në të gjitha nivelet duhet të ndër marrin përpjekje gjithëpërfshirëse ligjore, institucionale dhe edukuese për të kapërcyer stereotipet gjinore ekzistuese. Partitë politike duhet të identifikojnë dhe kufizojnë çdo pengesë të mundshme me bazë gjinore për kandidatet gra, duke përfshirë rishikimin e praktikave aktuale brenda partive që e pengojnë përfaqësimin më efektiv të grave brenda strukturave partiake dhe si kandidate.

KQZ-ja dhe KZAZ-të verifikuan të drejtën e kandidatëve për të kandiduar. Dyzet e tre kandidatë ishin ende nën hetim nga Prokuroria e Përgjithshme në ditën e zgjedhjeve, duke përfshirë pesë kandidatë për kryetarë bashkie që u zgjodhën.⁵⁷ Më datë 9 qershor, KQZ-ja dërgoi për hetim dosjen e kryebashkiakut të zgjedhur të Hasit.

Në një proces kryesisht gjithëpërfshirës, administrata zgjedhore regjistroi gjithsej 144 kandidatë për kryetarë bashkie, duke përfshirë 15 gra (10.4 për qind) dhe 23,763 kandidatë për këshillat bashkiakë, duke përfshirë 11,828 gra (49.8 për qind).⁵⁸ PS-ja dhe Koalicioni Bashkë Fitojmë (në vijim “Bashkë Fitojmë”) ishin të vetmet subjekte zgjedhore që dolën me kandidatë për të dyja garat pothuajse në të gjitha bashkitë.⁵⁹

Në bashkitë Himarë dhe Finiq (të dyja në qarkun e Vlorës), u zgjodhën kryetarë bashkie kandidatë nga partitë etnike greke: në Himarë kandidati që përfaqësonte Partinë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (pjesë e koalicionit Bashkë Fitojmë), kurse në Finiq kandidati i MEGA-s. Tetë kandidate gra, të gjitha përfaqësuese të PS-së, u zgjodhën kryetare bashkie. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR shprehën keqardhje që përzgjedhja e kandidatëve në përgjithësi bëhej në nivel qendror dhe jo në atë vendor.

⁵⁵ Të gjitha partitë dhe koalicionet duhej të dorëzonin lista me numrin e kandidatëve të barabartë me numrin e vendeve në këshillin bashkiak përkatës, plus një. Një kandidat mund të paraqitet vetëm në një listë, dhe renditja në listat e kandidatëve nuk mund të ndryshohet pas regjistrimit.

⁵⁶ MVZ-ja e ODIHR-it vuri në dukje se në 55 bashki, të paktën një listë e kandidatëve nuk i përmbushte kërkesat për kuotën gjinore. Për shembull, në Kukës, tetë lista nuk e përmbushnin kërkesën, ku disa lista kishin gjashtë meshkuj më shumë se gra, duke rezultuar në gjithsej 37 kandidate gra më pak. Në Kuçovë nëntë lista nuk respektuan kuotën gjinore, në Librazhd dhe Tropojë nga shtatë lista secila, në Divjakë, Klos, Këlcyrë, Kurbin, Malësi të Madhe dhe Selenicë nga pesë lista secila, në Bulqizë, Fushë-Arrëz, Gjirokastër, Has, Krujë, Përmet dhe Pustec nga katër lista në secilën bashki. Disa lista të kandidatëve gjithashtu nuk ishin në përputhje me numrin e caktuar të kandidatëve për listë.

⁵⁷ KQZ-ja verifikon që kandidatët i plotësojnë kërkesat e integritetit të përcaktuara me Ligjin për Dekriminalizimin. Nëse kërkohet hetim i mëtejshëm, KQZ-ja i referon çështjet e kandidatëve në Prokurorinë e Përgjithshme.

⁵⁸ Dy kandidatë të pavarur garuan për postet e kryetarit të bashkisë, si dhe dhjetë kandidatë të pavarur për zgjedhjet e këshillit vendor.

⁵⁹ Koalicioni Bashkë Fitojmë doli me kandidatë për të dyja garat në të 61 bashkitë, dhe PS-ja në 60 për kryetarë bashkie dhe 61 për këshillat vendorë. Dhjetë subjekte të tjera zgjedhore propozuan kandidatë për këshilltarë në të paktën gjysmën e bashkive (Partia Agrare Ambientaliste në të gjitha bashkitë). Përveç kësaj, PD-ja konkurroi në zgjedhjet për kryetar bashkie në 15 bashki dhe gjashtë parti të tjera në nga një bashki secila. Nëntë kandidatë romë ishin në listat e kandidatëve të partive të ndryshme që garojnë në zgjedhjet e këshillit vendor.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Periudha zyrtare 30-ditore e fushatës filloi më 14 prill dhe përfundoi një ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Zgjedhësit mund të zgjidhnin mes disa kandidatëve, duke u fokusuar së pari te gara mes kandidatëve për kryetarë bashkie e më pas, tek ajo për këshillat bashkiakë. Fushata u përqendrua tek partitë e mëdha, veçanërisht te PS-ja në pushtet dhe koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Ky i fundit drejtohej formalisht nga PL-ja, por në fakt dominohej nga PDKR-ja, e cila formalisht nuk e kishte statusin e një partie koalicioni, por paraqiti shumicën e kandidatëve të koalicionit që u zgjodhën bashkë me PL-në.⁶⁰

Në përgjithësi, u respektuan liritë themelore të tubimit paqësor dhe të shprehjes dhe subjektet zgjedhore bënë fushatë lirisht.⁶¹ Megjithatë, bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it në disa qarqe pretenduan se mbështetësit e opozitës u përballën me kërcënime që synonin pengimin e tyre për të mos marrë pjesë në aktivitetet e fushatës.⁶² Përveç kësaj, pati edhe akuza të shumta për blerje votash ose për dhënie stimuljsh financiarë që njerëzit të mos merrnin pjesë në zgjedhje, në shumicën e rasteve të pretenduara si të iniciuara nga PS-ja dhe aleatja e saj informale, Partia Socialdemokrate.⁶³ Më 12 maj, një kandidat për kryetar bashkie në Himarë nga koalicioni Bashkë Fitojmë u arrestua me akuzën e blerjes së votave.⁶⁴

Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje reale për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e hershëm tashmë të shitblerjes së votës dhe për rreziqet që ajo sjell për integritetin e zgjedhjeve. Denoncimi publik i praktikave të tilla para dhe gjatë fushatës nga palët kryesore të interesuara, duke përfshirë edhe nga zyrtarët shtetërorë dhe drejtuesit e partive, mund të shërbejë për frenimin e këtyre praktikave.

Fushata u përcaktua nga personalitetet kryesisht të drejtuesve të partive kryesore, zotit Rama të PS-së dhe zotit Berisha të PDKR-së, të cilët dolën në publik rregullisht në të gjithë vendin. Megjithëse ndonjëherë kishte diskutime specifike me fokus vendor, drejtuesit e partive dhe politikanë të tjerë zhvilluan me efektivitet një fushatë mbarëkombëtare, ku PS-ja theksonte vazhdimin e progresit infrastrukturor, kurse opozita përqendrohej në çështjet e korrupsionit, keqmenaxhimit të fondeve publike dhe migrimit. Atmosfera e fushatës ishte kryesisht e moderuar, por pati edhe retorika dhe një stil konfrontues, edhe në postera dhe video-spote, veçanërisht nga PS-ja.⁶⁵

Në përgjithësi, fushata nuk kaloi pa u vënë re, por nuk tërhoqi ndonjë vëmendje të madhe. Në Tiranë, MVZ-ja e ODIHR-it vuri re një prani të dukshme të materialeve të fushatës për ambiente të hapura që promovonin partitë dhe jo kandidatët, ku dukshëm mbizotëronte PS-ja.⁶⁶ Disa bashkëbisedues e informuan MVZ-në e ODIHR-it se hapësira e caktuar për ekspozimin e materialeve të fushatës ishte

⁶⁰ PDKR-ja paraqiti 55 nga 61 kandidatët për kryetarë bashkie dhe mbi 900 kandidatë për këshilltarë vendorë.

⁶¹ MVZ-ja e ODIHR-it ishte në dijeni të dy rasteve të dhunës. Më 11 prill, në Vaun e Dejës (qarku Shkodër) u hodh në erë një makinë e një drejtuesi vendor të PDKR-së. Më 19 prill u qëllua për vdekje një drejtues vendor i PSD-së dhe kandidat për këshilltar vendor në Shëngjin (qarku Lezhë). Policia nuk e konsideroi vrasjen si të lidhur me zgjedhjet.

⁶² MVZ-ja e ODIHR-it mori raportime të tilla nga qarqet e Dibrës, Durrësit, Gjirokastrës dhe Shkodrës.

⁶³ MVZ-ja e ODIHR-it mori raportime të tilla nga qarqet e Dibrës, Durrësit, Elbasanit, Gjirokastrës, Korçës, Lezhës, Shkodrës dhe Tiranës. Shihni gjithashtu *Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve Zgjedhore*.

⁶⁴ Kandidati i minoritetit grek u ndalua disa orë pasi z. Rama, në një emision të televizionit *Klan*, e quajti person "të pafytyrë", "injorant", "analfabet" që "angazhonte njerëz për të kërcënuar emigrantët".

⁶⁵ Z. Rama dhe PS-ja e portretizuan z. Berisha dhe Ilir Meta (kryetarin e PL-së) si mishërime të një të shkuare të errët, ndërsa PDKR-ja e cilësoi z. Rama dhe ministrat e tij si "mafia më e madhe në planet".

⁶⁶ Reklammat dhe posterat shpesh nuk përmbanin informacionin identifikues të kërkuar nga ligji. Më 3 maj, Komisioneri i kërkoi policisë që t'i heqë këto materiale deri më 5 maj.

e pamjaftueshme, duke e bërë të vështirë fushatën për kandidatët e rinj.⁶⁷ Megjithëse Kodi Zgjedhor e kufizon ndjeshëm përdorimin e materialeve statike të fushatës, si billbordet, Komisioneri vendosi se kjo nuk ishte pjesë e kompetencave të tij, duke e lejuar efektivisht ekspozimin e tyre.⁶⁸ Garuesit kryesorë organizuan tubime më të mëdha në ambiente të jashtme, ndërsa partitë e tjera garuese zhvilluan kryesisht takime me pak njerëz, vizita derë më derë, afishuan postera dhe përdorën rrjetet sociale. Këto të fundit u panë si mjete veçanërisht të përshtatshme dhe efektive për fushatë nga kandidatët pa burime financiare.

Në shumicën e tubimeve të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it pati edhe kandidate gra, por pjesëmarrja e grave në audiencë ishte relativisht e ulët.⁶⁹ Asnjë bashkëbisedues i MVZ-së së ODIHR-it nuk shprehu shqetësime apo raporto i ndonjë rast të retorikës mizogjene, kërcënimeve, gjuhës së urrejtjes ndaj grave politike, ose sulmeve në internet ndaj grave në kontekstin elektoral.

Facebook-u është rrjeti social mbizotërues në Shqipëri. 28 parti politike (nga 44 parti që garonin të pavarura ose si pjesë e koalicioneve) kishin një llogari në *Facebook*. PD-ja dhe PS-ja kishin më shumë ndjekës, përkatësisht rreth 328,000 dhe 204,000 ndjekës. Llogaritë e politikanëve në *Facebook* ishin shumë më popullore dhe gjatë fushatës prodhuan aktivitetin më të lartë. 39 kryetarë partish kishin llogari zyrtare në *Facebook*, ku ndër politikanët z. Rama kishte numrin më të lartë të ndjekësve (1.62 milionë), i ndjekur nga z. Berisha (1.12 milionë). Ndër politikanët kryesorë, z. Rama postoi 267 herë gjatë periudhës zyrtare të fushatës dhe prodhoi numrin më të madh të ndërveprimeve (2.23 milionë), ndërsa z. Berisha pati 331 postime me 0.63 milionë ndërveprime. Në të njëjtën kohë, një aktivitet i konsiderueshëm i fushatave të kandidatëve për kryebashkiakë të Tiranës u vu re në *Instagram* (në veçanti nga Erion Veliaj i PS-së) dhe në *Tik-Tok* (në veçanti nga Belind Këlliçi nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”).

Sipas Kodit Zgjedhor, autoritetet nuk mund të propozojnë apo miratojnë vendime që ofrojnë përfitime sociale për popullatën brenda katër muajve para ditës së zgjedhjeve dhe deri në formimin e qeverisë së re. Megjithatë, Komisioneri deklaroi publikisht se dispozita përkatëse ishte e zbatueshme vetëm për zgjedhjet parlamentare.⁷⁰ Një interpretim kaq i ngushtë dhe formalist, që pasqyron fjalët dhe jo frymën e ligjit, nuk garanton garë të barabartë.⁷¹

Si rezultat, ekzekutivi mori vendime të shumta për t’i ofruar popullatës përfitime sociale, gjë që u pa nga disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it si një keqpërdorim i burimeve administrative. Përveç vendimit të 31 marsit për dhënien e një bonusi prej 5,000 lekësh (rreth 44 euro) pensionistëve, qeveria mori mbi dhjetë vendime në prill për të rritur pagat e kategorive të ndryshme të nëpunësve

⁶⁷ Sipas ligjit, materialet e shtypura mund të ekspozohen vetëm brenda një distance prej pesë metrash nga zyra zgjedhore e subjektit zgjedhor përkatës ose në vendet publike të caktuara për këtë qëllim nga kryetarët e bashkive. Asnjë vendim i tillë nuk ishte i disponueshëm publikisht në pjesën më të madhe të faqeve të internetit të bashkive, duke përfshirë edhe bashkinë e Tiranës.

⁶⁸ Më 10 maj, Komisioneri hodhi poshtë një kërkesë të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK) për heqjen e tabelave të reklamave të PS-së në Tiranë pasi tabelat që mbanin materiale fushate ishin pronë private e autorizuar zyrtarisht për reklamim nga bashkia.

⁶⁹ Nga 65 ngjarjet e fushatës të vëzhguara nga MVZ-ja e ODIHR-it, gratë folëse u paraqitën në 39. Në të njëjtën kohë, përlllogaritjet për pjesëmarrjen e grave në audiencë varionin ndjeshëm, nga 0 në 90 për qind, me një mesatare prej rreth 30 për qind.

⁷⁰ Komisioneri e bëri këtë [deklaratë](#) gjatë një konference për shtyp më 30 mars.

⁷¹ Neni 91 i Kodit Zgjedhor (Ndalimi i përdorimit të burimeve administrative për të mbështetur subjektet zgjedhore) nuk synon të përcaktojë ndalime vetëm në lidhje me zgjedhjet parlamentare. Vendimi i Rregullatorit të KQZ-së nr. 9 i dhjetorit të vitit 2020, i miratuar me qëllim kufizimin e keqpërdorimit të mundshëm të burimeve administrative, parashikon: “Qëllimi [...] është vendosja e rregullave për marrjen e masave, monitorimin dhe parandalimin e aktiviteteve, sjelljeve të ndaluara ose përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të institucioneve qendrore dhe vendore, si dhe të administratës shtetërore, gjatë periudhës katër mujore para ditës së zgjedhjeve, me qëllim garantimin dhe sigurimin e paanshmërisë dhe trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike [...]”.

publikë, si mësuesit apo zjarrfikësit.⁷² Gjithashtu, z. Rama në disa raste e kushtëzoi mbështetjen e ardhshme të qeverisë për bashkitë me rezultatet e zgjedhjeve.⁷³ Më 2 maj, PDKR-ja i bëri thirrje Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar (SPAK), duke i konsideruar këto deklarata si kërcënime dhe duke kërkuar hetim penal për deklarata të tilla të bëra nga z. Rama gjatë gjithë fushatës. MVZ-ja e ODIHR-it vëzhgoi një model të përsëritur në të gjitha qarqet ku autoritetet vendore angazhoheshin në aktivitete të gjera si riparimet e infrastrukturës vendore, shpërndarja e ushqimeve ose ofertat e punësimit afatshkurtër, duke përfshirë edhe për komunitetet e pakicave kombëtare.

Përveç z. Rama, në fushatën e PS-së morën pjesë dukshëm të gjithë ministrat e qeverisë, nga një ministër për qark. Ministrat nuk kandidonin në këto zgjedhje, përveç njërit prej tyre. Shpesh nuk bëhej një dallim i qartë midis aktiviteteve të tyre zyrtare dhe aktiviteteve për fushatë. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR shprehën shqetësimin se KQZ-ja nuk reagoi menjëherë ndaj aktiviteteve të tilla, gjë që e përforcoi më tej avantazhin e PS-së gjatë fushatës.⁷⁴ Megjithëse KQZ-ja vendosi sanksione ndaj administratave vendore për keqpërdorim të burimeve administrative për qëllime fushate, sanksionet nuk u zbatuan në nivelin qendror të qeverisë.⁷⁵

Dispozitat ligjore në lidhje me fushatën, duke përfshirë ato kundër keqpërdorimit të burimeve administrative, duhet të rishikohen për të hequr paqartësitë dhe për të garantuar një garë të barabartë. Autoritetet, duke përfshirë administratën zgjedhore dhe organet e zbatimit të ligjit, duhet t'i trajtojnë të gjithë garuesit në zgjedhje në mënyrë të barabartë.

MVZ-ja e ODIHR-it mori një sërë raportimesh të besueshme në lidhje me rastet kur punonjësve të bashkisë iu tha të mbështesnin ose të votonin për PS-në ose kur ishin paralajmëruar të mos e mbështesnin opozitën.⁷⁶ Më 24 mars, PDKR-ja i kërkoi SPAK-ut të niste një hetim penal në lidhje me shpërndarjen dhe përdorimin e aplikacionit 'Aktiv1st' të prezantuar nga PS-ja në vitin 2022. PDKR-ja pretendoi se aplikacioni ishte përdorur brenda administratës publike të kontrolluar nga PS-ja për të garantuar që nëpunësit publikë vartës të mbështesnin aktivitetet e PS-së, drejtuesve të saj dhe zyrtarëve të lidhur me partinë në rrjetet sociale. PS-ja i mohoi publikisht këto pretendime. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it konfirmuan në raste të ndryshme se aplikacioni ishte në përdorim nëpër bashki dhe u perceptua si një mjet për të ngritur dhe promovuar profilin e PS-së në rrjetet sociale, shpesh me udhëzime nga eprorët përkatës të lidhur me PS-në.⁷⁷

Organet e zbatimit të ligjit duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të identifikuar dhe hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, duke përfshirë blerjen e votës, presionin ndaj zgjedhësve dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, në mënyrë tërësore, në kohë dhe në mënyrë

⁷² 1 euro është afërsisht 111 lekë (lekë shqiptare).

⁷³ Më 22 prill, në Kamëz, teksta iu referua në mënyrë nënçmuese një kandidati për kryetar bashkie të PDKR-së, z. Rama tha se "ata që do ta fusin gomarin me dy veshë të gjatë në bashki, mund ta harrojnë qeverinë. Harrojeni mbështetjen nga qeveria". Në një [postim në Facebook](#) të datës 23 prill, z. Rama prezantoi një projekt që do të zhvillohej në Shkodër dhe do të financohej plotësisht nga qeveria shqiptare dhe komentoi: "Ky është një nga projektet transformuese për Shkodrën, fati i të cilit është i lidhur fort me vullnetin e komunitetit shkodran më 14 maj".

⁷⁴ Neni 92.4 i Kodit Zgjedhor e mandaton KQZ-në t'i 'ndalojë' dhe t'i shpallë publikisht si të tilla aktivitetet që abuzojnë me burimet administrative.

⁷⁵ Sanksionet për keqpërdorim të burimeve administrative variojnë nga 1000 deri në 500,000 lekë. Në shumicën e rasteve, KQZ-ja vuri në zbatim sanksione nga 2,500 deri në 100,000 lekë. KAS-i gjobiti të paktën 16 kryebashkiakë me nga 100,000 lekë secili për fushatë të paligjshme në favor të PS-së në faqet zyrtare në *Facebook* të bashkive dhe/ose të kryetarëve të bashkive.

⁷⁶ MVZ-ja e ODIHR-it mori raportime të tilla nga qarqet Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Tiranë.

⁷⁷ Në vitin 2021, një publikim masiv i të dhënave personale të më shumë se 900,000 banorëve të Tiranës, të zotëruara nga strukturat e PS-së, zbuloi një sistem njerëzish të veçantë partiakë (*patronazhisti*) përgjegjës për qytetarët në bazë të vendbanimit të tyre. Ky sistem kontrolli dyshohet se është aktivizuar për të mbikëqyrur që qytetarët të marrin pjesë dhe të votojnë për PS-në.

transparente. Zgjedhësit duhet të informohen sistematikisht për mekanizmat e zbatueshme për denoncimin e shkeljeve, duke përfshirë mbrojtjen e denoncuesve dhe masat mbrojtëse ndaj pasojave.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës rregullohet kryesisht nga Kodi Zgjedhor së bashku me Ligjin për Partitë Politike, i cili mbulon aktivitetet e zakonshme të partive politike. Ndryshimet e vitit 2020 në Kodin Zgjedhor parashikuan kompensimin financiar paszgjedhor për subjektet zgjedhore që nuk plotësojnë kushtet për financim nga shteti përpara zgjedhjeve dhe ulën pragun nga 100,000 në 50,000 lekë për donacionet që duhet të transferohen në llogari të veçanta bankare. Ndryshimet e vitit 2020 e trajtuan pjesërisht një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it duke e zgjeruar të drejtën e KQZ-së për të verifikuar drejtpërdrejt të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës, por rekomandimet për raportimin e ndërmjetëm financiar dhe për rregullimin e financimeve të fushatave nga palët e treta mbeten të patrajtuara.

Garuesit mund t'i financojnë fushatat e tyre me fonde publike dhe private.⁷⁸ Partitë politike që morën të paktën 1 për qind të votave në mbarë vendin në zgjedhjet e fundit vendore kishin të drejtë për financim publik për fushatën e tyre.⁷⁹ Megjithëse Kodi Zgjedhor parashikon që fondet t'u shpërndahen partive politike jo më vonë se pesë ditë pas përfundimit të periudhës së regjistrimit të kandidatëve, pra deri më 9 prill, parlamenti i ka ndarë këto fonde (100 milionë lekë) më 26 prill, 12 ditë pas fillimit të fushatës.⁸⁰ Megjithatë, disa parti e informuan MVZ-në e ODIHR-it se i morën fondet vetëm më 12 maj, gjë që ndikoi negativisht në mundësinë e partive për t'i përdorur këto fonde për fushatë. Subjektet zgjedhore që nuk plotësojnë kushtet për financim publik mund të marrin kompensim pas zgjedhjeve.⁸¹ Në kundërshtim me praktikën e mirë ndërkombëtare, kandidatët e pavarur nuk kanë të drejtë për financim publik.⁸²

Vendimet për ndarjen dhe transferimin e fondeve publike për partitë politike përfituese duhet të merren në kohën e duhur për të garantuar akses efektiv në këto fonde për qëllime të fushatës. Mund t'i kushtohet vëmendje zgjerimit të financimit publik të fushatës për kandidatët e pavarur.

Fondet private mund të përfshijnë mjetet e vetë konkurrentëve, donacione nga shtetas dhe persona juridikë shqiptarë dhe kredi bankare. Donacionet individuale, duke përfshirë edhe ato në natyrë, kufizohen në 1 milion lekë.⁸³ Sipas KQZ-së, ky kufi vlen edhe për subjektet zgjedhore që dëshirojnë

⁷⁸ Ligji parashikon tre lloje të financimit publik për partitë politike bazuar në rezultatet e zgjedhjeve: për aktivitetet vjetore, aktivitetet e lidhura me zgjedhjet dhe kompensimin pas zgjedhjeve. Më 12 prill, KQZ-ja shpërndau 345,341,079 lekë (rreth 3 milionë euro) fonde publike vjetore për 11 parti.

⁷⁹ Paragrafi 232 i [Udhëzimeve për rregullimin e partive politike](#) të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2020 parashikon: "Sistemet [publike] të financimit duhet gjithashtu të synojnë të garantojnë që të gjitha partitë, duke përfshirë partitë opozitare, partitë e vogla dhe partitë e reja, të jenë në gjendje të konkurrojnë në zgjedhje në përputhje me parimin e mundësive të barabarta, duke përforcuar kështu pluralizmin politik dhe duke ndihmuar në garantimin e funksionimit të duhur të institucioneve demokratike".

⁸⁰ Më 22 prill, KQZ-ja vendosi shpërndarjen e rreth 97 milionë lekëve për 13 subjekte zgjedhore. Kështu, pragu i shpenzimeve iu bë i ditur garuesve vetëm tetë ditë pas fillimit të fushatës.

⁸¹ Për t'u kualifikuar për kompensim, një parti duhet të marrë jo më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në nivel kombëtar.

⁸² Paragrafi 185 i [Udhëzimeve për rregullimin e partive politike](#) të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2020 parashikon: "Në rastet kur partive politike iu sigurohet mbështetje shtetërore, si sigurimi i kohës së transmetimit të mediave publike ose financimi i fushatës, duhet të ketë gjithashtu një sistem mbështetjeje për kandidatët e pavarur për t'u garantuar që atyre t'iu jepet trajtim i barabartë në shpërndarjen e burimeve shtetërore".

⁸³ Personat juridikë që kanë marrë fonde të prokurimit publik mbi 10 milionë lekë, ata që janë përfshirë në projekte të partneritetit publik ose që kanë borxhe ndaj buxhetit të shtetit, si dhe ata që kryejnë veprimtari mediatike, nuk lejohen të bëjnë donacione për fushatat zgjedhore.

ta financojnë fushatën me burimet e veta. Nuk ka asnjë kufizim në vlerën e përgjithshme të donacioneve që mund të pranojë një kandidat ose parti.

Në vitin 2020, kufiri i shpenzimeve për fushatën e partive politike u ul nga 1,000 në 300 për qind të shumës më të lartë të financimit publik të ndarë për një parti në bazë të rezultateve të zgjedhjeve të fundit vendore.⁸⁴ Për këto zgjedhje, kufiri arriti në 128.5 milionë lekë (rreth 1.16 milionë euro). Me ligj nuk kërkohet asnjë raportim i ndërmjetëm për të ardhurat apo shpenzimet e fushatës. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime për mungesën e transparencës së financimit të fushatës përpara ditës së zgjedhjeve. Kjo e kufizon aftësinë e zgjedhësve për të bërë një zgjedhje të informuar.⁸⁵

Për të rritur transparencën, duhet të ketë publikime periodike të kontributeve financiare dhe shpenzimeve për fushatë përpara ditës së zgjedhjeve.

KQZ-ja mbikëqyr respektimin e rregulloreve për financimin e fushatës. Për këto zgjedhje, KQZ-ja angazhoi 119 monitorues, prania e të cilëve nëpër bashki mundësoi mbledhjen e informacionit për fushatën, duke kontribuar në mbikëqyrjen e përgjithshme. Raportet e rregullta të monitoruesve nuk përmbanin ndonjë informacion thelbësor për financimin e fushatës.⁸⁶

Garuesit duhet të dorëzojnë raporte financiare brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultateve të zgjedhjeve. Më 6 maj, KQZ-ja vendosi që partitë politike, koalicionet dhe kandidatët për kryetarë bashkie duhet të dorëzonin raporte financiare përmes një Sistemi të ri të Raportimit Financiar në Internet, duke e lehtësuar raportimin, publikimin, aksesin në informacionin financiar, dhe duke përmirësuar transparencën e financimit të fushatës. KQZ-ja duhet të caktojë audituesit për shqyrtimin e këtyre raporteve financiare dhe të publikojë raportet e audituesve 30 ditë pas dorëzimit të tyre. Në prill të vitit 2021, Rregullatori i KQZ-së vendosi afatet për publikimin e raporteve të financimit të fushatës: nga KQZ-ja brenda dy ditëve pas marrjes së raportit përkatës, kurse subjektet zgjedhore brenda tre ditëve pas dorëzimit.

Ligji parashikon një gamë të gjerë sanksionesh për shkeljet e financimit të fushatës, duke përfshirë gjopa nga 50,000 deri në 5,000,000 lekë, konfiskim të fondeve publike dhe pezullim të financimit publik deri në pesë vjet. Asnjë bashkëbisedues i MVZ-së së ODIHR-it nuk ngriti shqetësim për proporcionalitetin dhe efektivitetin e këtyre sanksioneve.

X. MEDIA

A. MJEDISI I MEDIAS

Mjedisi mediatik shqiptar është i larmishëm, me një sërë mediash që operojnë në një treg të kufizuar reklamash.⁸⁷ Konsumi i medias në internet është vazhdimisht në rritje dhe e ka zëvendësuar median

⁸⁴ Pragu mbahet për kandidatët e pavarur në 50 për qind.

⁸⁵ Sipas paragrafit 247 të Udhëzimeve për rregullimin e partive politike të ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias të vitit 2020, “Zgjedhësit duhet të kenë informacionin përkatës për mbështetjen financiare që iu jepet partive politike, pasi kjo ndikon në vendimmarrje dhe është një mjet për t’iu kërkuar llogari partive”. Shihni gjithashtu paragrafin 261.

⁸⁶ Sipas formularit të raportimit, monitoruesit e KQZ-së paraqesin informacion për zyrat zgjedhore, materialet e fushatës, aktivitetet/ngjarjet e fushatës dhe përdorimin e burimeve shtetërore, por nuk iu kërkohet të llogarisin apo vlerësojnë totalin e shpenzimeve të bëra nga subjektet zgjedhore. Sipas rregulloreve përkatëse të KQZ-së, monitoruesit duhet të dorëzojnë raporte të ndërmjetme në KQZ çdo dhjetë ditë, dhe raportin përfundimtar shtatë ditë pas ditës së zgjedhjeve.

⁸⁷ Mungesa e një mekanizmi për matjen e audiencës mediatike të pranuar gjerësisht paraqet sfida të mëtejshme për garën e ndershme dhe financimin e mediave.

e shkruar. Megjithatë, televizioni (TV) mbetet burimi kryesor i informacionit politik.⁸⁸ Mediat më të njohura në internet janë të lidhura me stacionet kryesore televizive dhe riprodhojnë përmbajtjen e tyre.

Disa probleme sistematike ndikojnë në lirinë e medias dhe gazetarisë, duke çuar në një dobësim të pavarësisë së medias për shkak të përqendrimit të pronësisë së medias dhe kontrollit të ushtruar nga interesat e ndërthurura të biznesit dhe politikës.⁸⁹ Të dy këta faktorë ndikojnë në autonominë editoriale të medias dhe i bëjnë gazetarët të cenueshëm ndaj presionit të pronarëve dhe politikanëve të mediave dhe autocensura.⁹⁰

Retorika diskredituese e politikanëve, pengesat në aksesimin e informacionit publik dhe kushtet e pasigurta të punës janë faktorë të tjerë kryesorë që ndikojnë tek profesionistët e medias dhe aftësia e mediave kryesore për të kryer raportime të pavarura dhe investigative.⁹¹

Autoritetet shtetërore duhet të promovojnë një mjedis mediatik të pavarur dhe vërtet të larmishëm, pa ndikime nga politika dhe biznesi. Parlamenti duhet ta ndryshojë Ligjin për mediat audiovizive për të kufizuar përqendrimin e pronësisë së mediave në sektorin e transmetimit dhe duhet të marrë masa për të parandaluar ndikimin e padrejtë të pronarëve të mediave mbi politikën editoriale.

Ekziston një praktikë e përhapur gjerësisht tek partitë kryesore politike dhe institucionet publike për t'u siguruar mediave pamjet e regjistruara paraprakisht ose pamje të drejtpërdrejta të ngjarjeve politike dhe të fushatës. Këto filmime përdoren gjerësisht nga transmetuesit në programet e tyre, duke përfshirë edhe në lajme, shpesh pa shënimin e duhur.⁹² Të gjithë bashkëbiseduesit e mediave të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dukje se kjo praktikë ndikon ndjeshëm në pavarësinë editoriale, pasi mediat, në vend që ta prodhojnë vetë përmbajtjen, mbështeten shumë në këto materiale. (shih gjithashtu pjesën *Gjetjet e Monitorimit të Medias*).⁹³

Përdorimi nga media i materialeve të prodhuara nga partitë ose autoritetet shtetërore në programet e lajmeve dhe informacionit duhet të shmangët ose të kufizohet në raste të jashtëzakonshme, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Sa herë që transmetohen materiale të tilla, duhet të identifikohen qartësisht si përmbajtje të prodhuara nga garuesit politikë, siç kërkohet me ligj. Për shkeljet që lidhen me kërkesat e ligjit për identifikimin e materialeve të tilla, duhet të vendosen sanksione dhe duhet të zbatohen.

⁸⁸ Shihni [Rezultatet e sondazhit të opinionit të marketingut strategjik IPSOS për besimin tek mediat](#) nga marsi i vitit 2021.

⁸⁹ [Komenti i përgjithshëm nr. 34](#) i KDNJ-së së OKB-së ndaj KNDKP-së në paragrafin 40 thotë: “Shtetet palë duhet të ndër marrin veprimet e duhura, në përputhje me Konventën, për të parandaluar dominimin ose përqendrimin e padrejtë të medias nga grupet e mediave të kontrolluara privatisht në situata monopoliste që mund të jenë të dëmshme për një shumëllojshmëri burimesh dhe pikëpamjesh”.

⁹⁰ [Raporti për Shqipërinë i vitit 2022](#) i BE-së vëren: “Grupet me profil të lartë të biznesit kanë rritur depërtimin e tyre ekonomik në tregun mediatik [...]. Organizatat mediatike dhe aktivistët vazhdojnë të ngrenë shqetësime për përdorimin e kanaleve mediatike për të promovuar interesat ekonomike të pronarëve dhe agjendat politike. Përqendrimi i tregut dhe audiencës dhe mungesa e transparencës së financimit të medias vazhdojnë të mbeten çështje shqetësuese për sa i përket lirisë së medias në vend”.

⁹¹ Shihni gjithashtu nënkaptullin Liria e Shprehjes (fq. 29-32) të [Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë të vitit 2022](#).

⁹² Kodi zgjedhor kërkon që materialet e prodhuara nga partitë të shënohen qartësisht si të tilla.

⁹³ Sipas paragrafit 26 të [Dokumentit të OSBE-së të Moskës të vitit 1991](#), “Shtetet pjesëmarrëse konfirmojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, duke përfshirë të drejtën për komunikim dhe të drejtën e medias për të mbledhur, raportuar dhe shpërndarë informacion, lajme dhe opinione”. Shihni gjithashtu paragrafin 9.1 të [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës](#) të vitit 1990.

B. KUADRI LIGJOR

Kushtetuta mbron lirinë e medias dhe të drejtën e informimit dhe ndalon censurën. Megjithatë, dispozitat ligjore në lidhje me aksesin në informacion nuk zbatohen në mënyrë të mjaftueshme dhe autoritetet prirën ta centralizojnë aksesin në të dhënat publike. Sipas shumicës së bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it, Agjencia e re për Media dhe Informim, e krijuar në shtator të vitit 2021 me synimin e deklaruar për të lehtësuar aksesin në informacion, e ka centralizuar më tej aksesin në informacionin publik. Disa gazetarë e informuan MVZ-në e ODIHR-it për përqindjen e ulët të përgjigjeve nga institucionet, të cilat nuk respektojnë afatet për dërgimin e informacionit të kërkuar, duke e bërë lajmin të papërdorshëm ose pa dokumente mbështetëse.⁹⁴ Përveç kësaj, shpifja mbetet një vepër penale e dënueshme me gjoba të kushtueshme.⁹⁵

Autoritetet duhet të garantojnë zbatimin e duhur të Ligjit për të Drejtën e Informimit, ta dekriminalizojnë shpifjen dhe të mbështesin gazetarinë e pavarur.

Transmetuesit rregullohen me Ligjin për mediat audiovizive. Në prill të vitit 2023, parlamenti miratoi ndryshimet për ta harmonizuar atë me Direktivën e BE-së për Shërbimet Mediatike Audiovizive. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dukje se reforma nuk trajtoi çështje kyçe si transparencën e pronësisë së medias, bashkërregullimin, vetërregullimin dhe pluralizmin e medias, por trajtoi vetëm çështje që nuk krijojnë polemika.

Mediat elektronike mbikëqyren nga Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), i cili ka kompetencën të japë dhe të heqë licenca dhe t'i sanksionojë transmetuesit me gjoba ose të pezullojë të drejtat e tyre të transmetimit. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vlerësojnë se AMA nuk është e pajisur mjaftueshëm për të përmbushur mandatin e saj të mbikëqyrjes së medias dhe vunë në pikëpyetje pavarësinë e saj.⁹⁶

Mbulimi i fushatës në mediat transmetuese rregullohet me Kodin Zgjedhor. Rregullat për ndarjen e minutazhit në lajme dhe programe informative u japin partive kryesore parlamentare një avantazh të konsiderueshëm.⁹⁷ Dispozitat e rrepta që rregullojnë ndarjen e kohës së transmetimit për subjektet zgjedhore u kritikuan nga disa bashkëbisedues mediatikë të MVZ-së së ODIHR-it. Ky sistem është i

⁹⁴ Paragrafi 19 i [Komentit të përgjithshëm nr. 34](#) të KDNJ-së së OKB-së ndaj KNDCP-së thotë: “Për t'i dhënë efekt të drejtës së aksesit në informacion, shtetet palë duhet të vendosin në mënyrë proaktive në mjedisin publik informacionin e qeverisë me interes publik. Shtetet palë duhet të bëjnë çdo përpjekje për të garantuar akses të lehtë, të shpejtë, efektiv dhe praktik në një informacion të tillë”.

⁹⁵ Kodi Penal parashikon gjoba deri në 3 milionë lekë për shpifje. MVZ-ja e ODIHR-it është në dijeni të dy rasteve të shpifjeve të iniciuara gjatë kësaj fushate zgjedhore. Më 18 prill, deputetja Monika Kryemadhi (Partia e Lirisë) [ngriti padi civile](#) ndaj Top Channel-it dhe njoftoi një padi penale në të ardhmen. Më 3 prill, kryebashkiaku i Tiranës Veliqaj depozitoi një [kallëzim penal](#) për shpifje ndaj Syri TV dhe gazetarit dhe producentit të emisionit investigativ “Piranjat”. Më 22 maj, media [raportoi](#) që z. Veliqaj e tërhoqi padinë. Një nga gazetarët e përfshirë e akuzoi kryebashkiakun e Tiranës se e përdori këtë padi si një mjet frikësimi në kulmin e fushatës zgjedhore.

⁹⁶ Sipas ligjit, [AMA](#) kërkohet të jetë politikisht e pavarur. Në korrik të vitit 2021, Përgjigja e Shpejtë për Lirinë e Medias [shprehu shqetësimin](#) për paanshmërinë dhe pavarësinë e AMA-s pas zgjedhjes së një bashkëpunëtori të ngushtë të PS-së si kryetar të rregullatorit. [Bashkimi Evropian](#) dhe [OSBE-ja](#) bënë thirrje për ta shtyrë emërimin deri në mbledhjen e parlamentit të ri në shtator të vitit 2021. Organizatat mediatike theksuan se kjo zgjedhje dukej të ishte në kundërshtim me [rekomandimin e Komisionit të Venecias](#) për përforcimin e pavarësisë së AMA-s.

⁹⁷ Partitë që fituan mbi 20 për qind të mandateve në zgjedhjet e fundit parlamentare duhet të kenë dy herë më shumë mbulim në lajme dhe programe informative sesa partitë e tjera parlamentare. Mbulimi i partive joparlamentare bëhet me zgjedhjen e transmetuesve, por nuk mund ta kalojë mbulimin e ofruar për partitë parlamentare me më pak se 20 për qind të mandateve.

padrejtë ndaj partive më të vogla dhe bie ndesh me angazhimet e OSBE-së dhe praktikat e mira ndërkombëtare.⁹⁸

Rregullat e Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës së transmetimit për garuesit zgjedhorë duhet të ndryshohen për të reduktuar avantazhin e partive kryesore parlamentare në programet editoriale dhe për të garantuar një ndarje më të drejtë të kohës për të gjitha partitë garuese.

Dispozitat për kohën e transmetimit pa pagesë në transmetuesin publik, Radio-Televizioni Shqiptar (RTSH), garantojnë shikueshmëri për të gjithë garuesit në zgjedhje bazuar edhe në përfaqësimin e tyre parlamentar.⁹⁹ Reklamata zgjedhore me pagesë në mediat e transmetimit u nënshtrohet disa kufizimeve.¹⁰⁰ Janë ndërmarrë masa për transparencën e garantimit të mundësive të barabarta në kanalet televizive dhe radiofonike, të cilat duhet t'i dorëzojnë informacion KQZ-së në lidhje me tarifatat që aplikojnë. Megjithatë, në faqen e KQZ-së, listat e çmimeve janë publikuar vetëm për 20 transmetues, megjithëse ka pasur më shumë kanale që kanë transmetuar reklama zgjedhore pa depozituar informacionin e kërkuar. Disa prej transmetuesve ofruan shërbime të marrëdhënive me publikun, sipas tarifave përkatëse.¹⁰¹ Kriteret në lidhje me reklamimin me pagesë nuk zbatohen për mediat në internet. Ky boshllëk ligjor u kritikua nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, të cilët shprehën shqetësime për mungesën e masave për adresimin e transparencës dhe për shënjestrimin e reklamave zgjedhore në internet.

AMA mbikëqyr respektimin e kërkesave ligjore për mbulimin e fushatës nga transmetuesit. Autoriteti i medias e përmbushi mandatin e tij të monitorimit dhe i siguroi KQZ-së raporte ditore dhe periodike për mbulimin e fushatës në media, të cilat u publikuan në faqen e internetit të KQZ-së. Raportet treguan se shumica e shkeljeve kishin të bënin me mosparaqitjen e regjistrimeve të materialit të transmetuar tek AMA, si dhe shkeljet që lidhen me reklamata politike.¹⁰² Bazuar në gjetjet e AMA-s, KQZ-ja vendosi disa sanksione ndaj transmetuesve për shkeljet e konstatuara, përgjithësisht në përputhje me rekomandimet e AMA-s.¹⁰³ Gjithashtu u konstatuan pabarazi në mbulimin mediatik, ku KQZ-ja u kërkoi transmetuesve të garantojnë kompensim për partitë e nënpërfaqësuar. Megjithatë, disa transmetues nuk i respektuan vendimet përkatëse të KQZ-së.

Për shkak të pajisjeve të vjetra dhe kufizimeve teknike dhe materiale, monitorimi i AMA-s u përqendrua vetëm në ndarjen e kohës së transmetimit dhe nuk regjistroi elementë të tjerë të mbulimit, duke përfshirë shënimin në materialet e gatshme të partive dhe tonin e raportimit. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it iu referuan raporteve të AMA-s si të paqarta sa u përket të dhënave të paraqitura.

⁹⁸ Paragrafi 7.8 i [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës](#) të vitit 1990 kërkon nga shtetet të "garantojnë që të mos ketë asnjë pengesë ligjore ose administrative në aksesin e papenguar në media mbi baza jodiskriminuese për të gjitha grupimet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor". Paragrafi 8.5 i [Rezolutës së APKE-s nr. 1636](#) të vitit 2008 thekson se "partitë politike dhe kandidatët duhet të kenë akses të drejtë dhe të barabartë në media".

⁹⁹ [Vendimi i KQZ-së nr. 352](#) (në shqip) parashikoi për PS-në dhe PD-në 50 minuta në televizionin publik dhe 30 minuta në radion publike. Partitë e tjera parlamentare kishin të drejtë për 25 minuta në televizion dhe 15 minuta në radio, dhe partitë joparlamentare secila nga 10 minuta në televizion dhe radio. Koha e transmetimit falas u caktua në RTSH-2, e cila ka një shikueshmëri më të vogël dhe përqendrohet kryesisht tek pakicat kombëtare dhe grupet e marginalizuara.

¹⁰⁰ Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të blejnë reklama politike në televizion dhe radio, si dhe vendosen kufizime për sasinë totale të kohës së transmetimit që mund të blihet. Transmetuesit duhet të zbatojnë të njëjtat tarifa për të njëjtën hapësirë kohore, dhe reklama e fushatës mund të transmetohet vetëm nga ora 15.00 deri në 18.00 dhe nga ora 21.00 deri në 24.00.

¹⁰¹ Disa stacione televizive ofruan shërbime me pagesë për ftesën e politikanëve dhe kandidatëve si të ftuar në studio, intervistat e kandidatëve, pjesëmarrjen në *talk show*, etj.

¹⁰² Pjesa më e madhe e shkeljeve lidhen me transmetimin e reklamave gjatë orareve të ndaluara. Dy kanale e tejkaluan kufirin e lejuar prej 90 minutash për reklamata zgjedhore.

¹⁰³ Në raportet e saj periodike, AMA propozoi sanksione për shkeljet e konstatuara për shqyrtim nga KQZ-ja.

Autoriteti i Mediave Audiovizive duhet të pajiset me burime të mjaftueshme materiale dhe teknike për të rritur kapacitetin e tij monitorues dhe raportues të medias.

C. GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAS

Rezultatet e monitorimit të medias të MVZ-së së ODIHR-it tregojnë se mbulimi i fushatës u përqendrua kryesisht tek kryetarët e partive kombëtare, si dhe tek kandidatët për kryetar bashkie të Tiranës, ndërsa garuesit e tjerë morën pak vëmendje.¹⁰⁴ Megjithëse 51 për qind e kohës së përgjithshme të transmetimit iu kushtua aktorëve politikë që nuk ishin kandidatë, 28 për qind iu kushtua kandidatëve për kryetar bashkie të Tiranës dhe 21 për qind kandidatëve në bashkitë e tjera. Vetëm 9 për qind e mbulimit iu kushtua kandidateve gra. Fushata mediatike u karakterizua nga sulme personale të përsëritura ndërmjet politikanëve dhe mungesa e debateve mes garuesve. Kandidatët dhe media u kushtuan vëmendje të kufizuar politikave dhe çështjeve të rëndësishme në nivel vendor. Vetëm 22 për qind e mbulimit të monitoruar iu kushtua çështjeve thelbësore të politikave. Transmetuesit më së shumti përdornin ato që dukej të ishin materiale partiake të regjistruara paraprakisht, rrallëherë të pajisura me shënime, dhe nuk arrinin të siguronin një mbulim gjithëpërfshirës dhe objektiv të fushatës. Rreth 38 për qind e mbulimit të lajmeve të monitoruara u konfirmuan ose kishin gjasa të ishin materiale të prodhuara nga partitë. Vetëm 5 për qind e këtij materiali ishte shënuar në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Mbulimi i fushatës në të gjitha mediat e monitoruara u përqendrua kryesisht tek PS-ja (40 për qind), Bashkë Fitojmë (37 për qind) dhe në një masë më të vogël tek PD-ja (15 për qind). Së bashku, ato morën 92 për qind të mbulimit të përgjithshëm të fushatës së monitoruar. Në programet e saj të lajmeve dhe informacionit, *RTSH*-ja e ndau kohën më të madhe të transmetimit mes PS-së (43 për qind) dhe koalicionit Bashkë Fitojmë (35 për qind), ndërsa PD-ja mori 17 për qind. Në *TV Klan*, PS-ja mori 39 për qind, Bashkë Fitojmë 35 për qind dhe PD-ja 21 për qind të mbulimit. *Top Channel* i kushtoi PS-së 51 për qind, ndërsa Bashkë Fitojmë dhe PD-së iu dha përkatësisht 32 dhe 6 për qind të mbulimit të fushatës. Bashkë Fitojmë mori pjesën më të madhe të mbulimit në *Vizion Plus* (40 për qind), e pasuar nga PS-ja (33 për qind) dhe PD-ja (16 për qind). *A2 CNN* e përqendroi gjithashtu mbulimin e saj tek PS-ja (41 për qind), Bashkë Fitojmë (40 për qind) dhe PD-ja (16 për qind). Toni i mbulimit ishte kryesisht neutral ose pozitiv në të gjitha televizionet e monitoruara, me përjashtim të *Top Channel-it*, i cili i dha PS-së një ekspozim pozitiv mbi mesataren (29 për qind) dhe një mbulim pak negativ koalicionit Bashkë Fitojmë (7 për qind).

XI. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE ZGJEDHORE

Kodi Zgjedhor ofron një kuadër të kënaqshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore, me një procedurë të hollësishme ankimore administrative dhe garanci të procesit të rregullt ligjor. Sipas ligjit, garuesit, interesat ligjore të të cilëve preken, mund t'i ankimojnë vendimet e KZAZ-së në KQZ brenda tre ditëve nga shpallja e vendimit.¹⁰⁵ Ndërkohë që vëzhguesit mund të ankimojnë vetëm mohimin e akreditimit të tyre, zgjedhësit mund të ankohen në lidhje me mospërfshirjen e tyre në listën e zgjedhësve, dhe çdo person juridik ose fizik ka të drejtë të ankohet tek Komisioneri për shkelje në lidhje me zgjedhjet.¹⁰⁶

¹⁰⁴ Nga 14 prilli deri më 14 maj, MVZ-ja e ODIHR-it kreu monitorim të prime-time-it në pesë stacione televizive: *RTSH-1* publike dhe *Top Channel*, *TV Klan*, *Vizion Plus* dhe *A2 CNN* private.

¹⁰⁵ Ankimimet që nuk i plotësojnë kushtet formale mund të riparqiten me korrigjime brenda 24 orëve.

¹⁰⁶ Ankimime të tilla hetohen nga Komisioneri, i cili mund t'i drejtohet KAS-it për të vendosur sanksione. Shqyrtimi i sanksioneve administrative ose vendosja e masave disiplinore nga KAS-i bëhet brenda 30 ditëve, por jo më vonë se 6 muaj. Ankimuesit që nuk janë subjekte zgjedhore mund ta ankimojnë vendimin e KAS-it në gjykatat administrative.

Vendimet e Komisionerit dhe të KZAZ-ve mund të ankimohen në KAS.¹⁰⁷ Vendimet e KAS-it dhe Rregullatorit të KQZ-së mund të ankimohen në Kolegjin Zgjedhor, vendimet e të cilit janë përfundimtare.¹⁰⁸ KAS-i ka një afat dy-ditor, dhe Kolegji Zgjedhor ka dhjetë ditë kohë për të marrë vendim për ankesat apo ankimimet e marra. Të dyja shkallët kanë dhjetë ditë kohë për të marrë vendim për rastet që kanë të bëjnë me rezultatet e zgjedhjeve.¹⁰⁹ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime lidhur me atë që ata e perceptuan si vendimmarrje të njëanshme të KAS-it, duke e kundërshtuar kështu perceptimin e paanshmërisë së këtij organi.¹¹⁰ Në disa raste, KAS-i mori vendime kontradiktore, duke mos arritur të krijojë një interpretim të qëndrueshëm të ligjit.¹¹¹ Në disa raste, argumenti kryesor për ta hedhur poshtë një ankimim ishte mungesa e kuorumit të KAS-it, duke i lënë kështu paditësit pa zgjidhje juridike efektive në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe praktikën e mirë ndërkombëtare.¹¹²

Për të garantuar sigurinë juridike dhe zgjidhje juridike efektive, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve duhet të sigurojë një vendimmarrje uniforme, duke shmangur arsyetimet ligjore të paqëndrueshme.

Para ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja mori 438 raportime nga organizata të shoqërisë civile (OSHC) dhe subjekte zgjedhore për mosraportimin e pretenduar të aktiviteteve publike nga institucionet shtetërore dhe bashkiake brenda katër muajve para ditës së zgjedhjeve, keqpërdorim të burimeve administrative dhe shkelje të tjera të lidhura me fushatën. Komisioneri e trajtoi shumicën e këtyre raportimeve duke i kërkuar KAS-it vendosjen e sanksioneve ose lëshoi njoftime për organet publike. KAS-i gjykoi 49 çështje, kryesisht në lidhje me regjistrimin e kandidatëve, keqpërdorimin e burimeve administrative dhe shkelje të tjera të lidhura me fushatën, dhe vendosi sanksione në 17 raste të keqpërdorimit të burimeve administrative dhe shkeljeve të tjera të lidhura me fushatën, me sanksione që variojnë nga 2,500 deri në 100,000 lekë.¹¹³ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it i konsideruan sanksionet prej 2,500 lekësh si shumë të ulëta dhe jo dekurajuese. KAS-i i gjykoi ankimimet në seanca publike,

¹⁰⁷ Sipas rregullores së procedurës së KAS-it, pas regjistrimit të një ankimimi, hidhet shorti për të caktuar një relator nga radhët e anëtarëve të KAS-it, i cili verifikon nëse një ankimim është i pranueshëm. Nëse një ankimim pranohet, një seancë dëgjimore publike duhet të zhvillohet ndërmjet 24 dhe 48 orëve.

¹⁰⁸ Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë nga gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit, të emëruar me short për një mandat katërvjeçar. Shtatë nga këta gjyqtarë janë gra. Rastet shqyrtohen nga një panel prej pesë gjyqtarësh.

¹⁰⁹ Ankimimet lidhur me rezultatet e zgjedhjeve mund të paraqiten brenda pesë ditëve nga marrja e vendimit në fjalë.

¹¹⁰ KAS-i në përbërjen e tij aktuale përfshin avokatë, zyrtarë të lartë publikë dhe ekspertë ligjorë. Një nga anëtarët ishte një zyrtar i lartë i qeverisë dhe partisë politike. Të pesë anëtarët aktualë të KAS-it janë burra.

¹¹¹ Në vendimin e tij nr. 45, të datës 4 prill, KAS-i arriti në përfundimin se dispozitat e Nenit 91.1 të Kodit Zgjedhor janë të paqarta për shkak se nuk është përcaktuar periudha e ndalimit të përdorimit të burimeve administrative. KAS-i vendosi se ndalimi zbatohet vetëm gjatë periudhës zyrtare 30-ditore të fushatës zgjedhore, duke mos marrë parasysh faktin se në Vendimin e Rregullatorit nr. 9 parashikohet një periudhë katër-mujore (shihni Nenet 3.1.3.a dhe 3.2). Në rastin konkret, në datën 7 shkurt, Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, së bashku me Ministrin e Drejtësisë dhe kryebashkiakun e Lezhës, vizituan Spitalin Rajonal të Lezhës. Më 8 shkurt, informacioni për këtë vizitë u postua në profilin në *Facebook* të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke promovuar kështu kryebashkiakun në detyrë që kandidonte për rizgjedhje. KAS-i nuk vendosi gjobë për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shkak se shkelja ishte kryer jashtë periudhës zyrtare 30-ditore të fushatës.

¹¹² Paragrafi 5.10 i Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës të vitit 1990 i angazhon shtetet pjesëmarrëse që t'i sigurojnë të gjithëve "mjete efektive korrigjimi ndaj vendimeve administrative, në mënyrë që të garantohet respektimi i të drejtave themelore dhe të garantohet integriteti ligjor". Seksioni II.3.3.b i [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) rekomandon që "Procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalizëm, veçanërisht në lidhje me pranueshmërinë e ankimimeve". Më 2 maj, KAS-i mori vendimin për ta rrëzuar një ankesë nga PL-ja për shkak të mungesës së kuorumit prej tre anëtarësh të KAS-it për të miratuar një vendim, edhe pse katër anëtarë të KAS-it i kishin paraqitur argumentet e tyre më herët në seancë. Ky vendim u rrëzua më pas nga Kolegji Zgjedhor, dhe më 10 maj, KAS-i mori një vendim të ri.

¹¹³ Bashkitë dhe institucionet shtetërore paraqitën gjashtë ankimime kundër vendimeve të sanksioneve në Kolegjin Zgjedhor.

me pjesëmarrjen e palëve në çështje. Ndonjëherë, seancat e KAS-it shpallehin vetëm disa orë përpara ose mbaheshin pa njoftim paraprak.¹¹⁴ Disa vendime të KAS-it të marra para ditës së zgjedhjeve u publikuan vetëm pas ditës së zgjedhjeve.¹¹⁵ Rreth 75 ankimime për shkelje të lidhura me zgjedhjet nuk u zgjidhën deri më 14 maj.

KQZ-ja mori 44 ankesa në ditën e zgjedhjeve, disa prej tyre pretendonin shkelje të fushatës, dhe i trajtoi ato pas ditës së zgjedhjeve. Më 15 dhe 18 maj, KAS-i trajtoi katër kërkesa të Komisionerit për vendosjen e sanksioneve në lidhje me keqpërdorimin e burimeve administrative dhe ekspozimin e materialit të fushatës dhe miratoi tre prej tyre.

Para ditës së zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor gjykoi 15 ankimime, të gjitha brenda afateve ligjore dhe në seanca publike. Në tre raste, vendimet e ankimuara të KAS-it janë prishur. Vendimet e Kolegjit Zgjedhor ishin të arsyetuara mirë dhe disa dispozita të Kodit Zgjedhor u interpretuan për të garantuar mbrojtjen e të drejtës së votës, gjë që kontribuoi në sigurinë juridike.¹¹⁶ Megjithatë, disa vendime u publikuan në faqen e internetit të gjykatës me vonesa të konsiderueshme nga një deri në tre javë.

Ndërmjet 15 dhe 24 majit, Kolegji Zgjedhor shqyrtoi gjashtë ankimime ndaj sanksioneve administrative të vendosura për keqpërdorim të burimeve administrative gjatë promovimit të PS-së. Një ankimim u hodh poshtë për shkak se paditësi (bashkia e Shijakut) nuk kishte të drejtë ligjore dhe tri çështje u pushuan pasi përfaqësuesit e paditësve nuk ishin të pranishëm. Një çështje u dërgua në Gjykatën Administrative të Tiranës pasi paditësi nuk ishte subjekt elektorale.¹¹⁷ Ankimimi i fundit, lidhur me një gjobë prej 100,000 lekësh të vendosur nga KAS-i ndaj kryebashkiakut të Elbasanit, u shqyrtua në themel dhe u rrëzua. Pas gjykimit, në faqen e gjykatës u publikuan informacione për palët në çështje, përrshkrime të shkurtra të çështjeve dhe rezultate.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe ankimimet në kohën e duhur dhe të jetë i përgatitur siç duhet dhe të ketë burimet për ta bërë këtë. Për të garantuar transparencë, të gjitha vendimet për mosmarrëveshjet zgjedhore duhet të publikohen menjëherë dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë.

MVZ-ja e ODIHR-it u informua se para ditës së zgjedhjeve, zyrat e policisë në të gjithë vendin kishin marrë dhe hetuar 54 denoncime për shkelje të lidhura me zgjedhjet, duke përfshirë 25 raste të blerjes së votave dhe 20 raste të shitjes së votave. Policia e Shtetit evidentoi edhe pesë krime elektorale gjatë ditës së zgjedhjeve. Shkeljet zgjedhore të lidhura me korrupsionin ndiqen penalisht nga SPAK-u, i cili ka marrë 13 denoncime të lidhura me zgjedhjet dhe ka nisur 6 hetime penale paraprake para ditës së zgjedhjeve, duke përfshirë 4 raste për blerje votash. Në ditën e zgjedhjeve, SPAK-u mori 21 denoncime nga subjekte zgjedhore dhe qytetarë.

XII. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin nga vëzhgues vendas dhe ndërkombëtarë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. OSHC-të e specializuara ose të angazhuara në fushën e mirëqeverisjes dhe demokratizimit, mediat dhe përfaqësuesit e partive mund të akreditoohen për të vëzhguar. Në një proces gjithëpërfshirës, KQZ-ja akreditoi 452 vëzhgues vendas nga 9 OSHC dhe 557 vëzhgues nga

¹¹⁴ Për shembull, më 22 maj, KAS-i zhvilloi një seancë pa njoftim paraprak. Të gjitha informacionet lidhur me vendimet e miratuara të palëve në çështje u siguruan përmes email-it pas seancës.

¹¹⁵ Për shembull, vendimet e KAS-it të miratuara më 13 maj (Nr. 92, 94, 103 dhe 111) u publikuan më 18 maj.

¹¹⁶ Në rastin e Nismës Thurje/Kosta Garos kundër KQZ-së, më 13 prill, Kolegji Zgjedhor vendosi se mosregjistrimi i kandidatit për shkak të pretendimit të mungesës së dokumentacionit ishte në kundërshtim me parimin kushtetues të pluralizmit dhe të drejtën për t'u zgjedhur.

¹¹⁷ Sipas ligjit, vetëm subjektet zgjedhore mund të ankohen në Kolegjin Zgjedhor.

16 organizata ndërkombëtare dhe 15 ambasada, si dhe 33 media vendore me 1,114 përfaqësues të medias. KZAZ-të akredituan vëzhgues partiakë në zonat e tyre përkatëse.

Partitë dhe koalicionet parlamentare kanë përfaqësues të përhershëm në KQZ. Subjektet e tjera zgjedhore mund të caktojnë përfaqësues për periudhën zgjedhore. Pasi regjistrohen, subjektet zgjedhore mund të caktojnë një vëzhgues në KZAZ-të dhe KQV-të në zonën ku garojnë dhe të vëzhgojnë veprimtarinë e çdo grupi numërimi në VNV-të përkatëse. Koalicionet, pavarësisht nga numri i partive që janë pjesë e tyre, mund të delegojnë deri në tre përfaqësues për komision ose grup numërimi.

Vëzhguesit vendas ishin të pranishëm në 6 për qind të qendrave të votimit dhe në 37 për qind të VNV-ve të vëzhguara nga MNVZ-ja, ndërsa vëzhguesit partiakë ishin të pranishëm përkatësisht në 86 dhe 97 për qind të qendrave të votimit dhe vendeve të numërimit.

OSHC të ndryshme monitoruan përdorimin e burimeve administrative dhe respektimin e rregulloreve të fushatës dhe depozituan raportimet e tyre në rastet e shkeljeve në KQZ.¹¹⁸ Disa OSHC e informuan MVZ-në e ODIHR-it se për shkak të burimeve të kufizuara financiare, ata dërguan vetëm një numër të vogël vëzhguesish në ditën e zgjedhjeve.

XIII. DITA E ZGJEDHJEVE

Në përgjithësi, dita e zgjedhjeve ishte paqësore por u ndikua negativisht nga raste të shumta të ndërhyrjeve të partive në proces, si dhe nga problemet teknike dhe procedurale. Në disa raste, MNVZ-ja nuk u lejua të vëzhgoje proceset e votimit dhe numërimit.¹¹⁹ KQZ-ja njoftoi një pjesëmarrje në votime prej 38.23 për qind të të gjithë zgjedhësve të regjistruar, duke përfshirë ata që banojnë jashtë vendit.

A. HAPJA DHE VOTIMI

Procesi i hapjes u vlerësua negativisht në 40 nga 101 qendrat e votimit të vëzhguara. MNVZ-ja vuri re probleme me vënien në punë dhe funksionimin e pajisjeve PEI, në disa raste për shkak të mosparaqitjes së operatorit të PEI-t në punë (26 raportime), KQV-së që nuk u tregoi të gjithë të pranishmëve se kutitë e votimit ishin bosh (24 raportime) dhe procesverbalit të padepozituar të vulosjes së kutive të votimit (10 raportime). Në 17 qendra votimi të vëzhguara, anëtarë jo të KQV-ve, shpesh vëzhgues dhe aktivistë partiakë, ndërhyjnë gjatë hapjes. Dy të tretat e qendrave të votimit të vëzhguara u hapën për votim me më shumë se 15 minuta vonesë, kurse shtatë qendra me më shumë se një orë vonesë.

Votimi u vlerësua negativisht në 7 për qind të vëzhgimeve, gjë që është shqetësuese. Qendrat e votimit të vëzhguara në zonat urbane u vlerësuan më pak negativisht (4 për qind vlerësime negative) sesa në zonat rurale (10 për qind vlerësime negative).¹²⁰ Vlerësime të tilla kanë të bëjnë me problemet procedurale, praninë e personave të paautorizuar, organizimin e qendrave të votimit që nuk favorizon ruajtjen e fshehtësisë së votës, si dhe rastet e votimit në grup, votimin në emër të personave të tjerë dhe votimin me asistimin e personave të tjerë. Në zonat rurale, MNVZ-ja vëzhgoi votime në grup në 20 për qind të qendrave të vëzhguara të votimit, në krahasim me 5 për qind në zonat urbane.

¹¹⁸ Këto OSHC përfshijnë KRIIK-un, Komitetin Shqiptar të Helsinkit dhe Qëndresën Qytetare.

¹¹⁹ Raste të tilla janë raportuar nga KZAZ-të 18, 52 dhe 82.

¹²⁰ Rreth 54 për qind e qendrave të votimit të vëzhguara nga MNVZ-ja ishin në zona urbane. Në qarqet e Lezhës, Korçës dhe Tiranës, MNVZ-ja e vlerësoi më negativisht procesin e votimit, dhe më pozitivisht në Gjirokastër dhe Dibër.

Në 11 për qind të qendrave të votimit të vizituara, MNVZ-ja vëzhgoi persona që nuk ishin anëtarë të KQV-ve që mbanin shënim zgjedhësit që votonin dhe kjo praktikë ishte më e zakonshme në zonat urbane (e vëzhguar në 16 për qind të qendrave të vizituara të votimit) sesa në zonat rurale (5 për qind). Persona të paautorizuar, zakonisht aktivistë partiakë, ishin të pranishëm në 4 për qind të qendrave të vëzhguara të votimit, kurse në 6 për qind prej tyre, persona që nuk ishin anëtarë të KQV-ve, kryesisht vëzhgues dhe aktivistë partiakë, ndërhyjnë ose drejtonin procesin e votimit. Tensione apo shqetësime u raportuan në ambientet e jashtme të 2 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara dhe brenda 2 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Materiale ose aktivitete fushate u vunë re në afërsi të 3 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. MNVZ-ja vëzhgoi raste presionesh ndaj zgjedhësve në 1 për qind të qendrave të votimit të vizituara. Vëzhguesit partiakë dhe vëzhguesit vendas qytetarë ishin të pranishëm përkatësisht në 86 dhe 6 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, pr në disa raste, vëzhguesit qytetarë dukej se përfaqësonin interesat e partive politike.

Pajisjet PEI nuk funksiononin ose operatori i pajisjeve PEI nuk ishte paraqitur në punë në 9 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara. Në 20 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara ku funksiononin pajisjet PEI, jo çdo zgjedhës mund të identifikohet prej këtyre pajisjeve. Procedurat e bojës, një mbrojtje e rëndësishme ndaj votimit të shumëfishtë, nuk u ndoqën gjithmonë: në 27 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, jo të gjithë zgjedhësit u kontrolluan nëse e kishin shenjën e bojës që nuk hiqet, dhe në 11 për qind të qendrave të vëzhguara të votimit, jo të gjithë zgjedhësit u shenjua me bojë përpara se të votonin. Në 30 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, një ose më shumë persona që nuk ishin në listën e zgjedhësve u kthyen mbarpsht ose u drejtuan për në qendrat e duhura të votimit.¹²¹

Procedurat e votimit në përgjithësi u respektuan, por në 10 për qind të qendrave të votimit, MNVZ-ja vërejti se jo të gjithë zgjedhësit i plotësuan fletët e votimit e tyre në fshehtësi, më shpesh në zonat rurale (14 për qind e vëzhgimeve) krahasuar me 6 për qind në zonat urbane.¹²² MNVZ-ja vëzhgoi gjithashtu një sërë shkeljesh procedurale, duke përfshirë votimin në grup (12 për qind) dhe votimin në vend të personave të tjerë (3 për qind). Në 3 për qind të qendrave të votimit të vizituara, MNVZ-ja vëzhgoi përpjekje për të ndikuar tek zgjedhësit se për cilin duhet të votonin. Gjithashtu, në 3 për qind të qendrave të vëzhguara të votimit, u panë raste ku i njëjti person ndihmonte më shumë se një zgjedhës, në kundërshtim me ligjin. Në një numër të kufizuar qendrash votimi me votim elektronik, MNVZ-ja vërejti se shpesh (15 nga 41 vëzhgime), veçanërisht zgjedhësit e moshuar, kishin probleme me përdorimin e aparateve të votimit dhe se ndihma e dhënë për këta zgjedhës cenonte fshehtësinë e votës.

Për të garantuar fshehtësinë e votës dhe për të parandaluar presionin ndaj zgjedhësve, votimin në grup dhe votimin në vend të personave të tjerë, autoritetet duhet të zbatojnë masa mbrojtëse procedurale efektive.

MNVZ-ja vërejti se kutitë e votimit nuk ishin të vulosura siç duhet në 1 për qind të qendrave të votimit të vizituara, kurse në 5 për qind prej tyre, numrat serialë të vulave të kutive të votimit nuk ishin regjistruar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së. Pothuajse 6 për qind e qendrave të votimit të vëzhguara ishin të mbipopulluara, kurse në 5 për qind prej tyre, mënyra e organizimit të qendrës së votimit nuk ishte e përshtatshme për të zhvilluar votimin. Në 3 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, MNVZ-ja e vlerësoi negativisht respektimin e procedurave të përcaktuara dhe njohjen e procedurave nga zgjedhësit. Rreth 60 për qind e qendrave të votimit të vëzhguara nuk ishin

¹²¹ KQZ-ja zhvendosi 29 qendra votimi afër ditës së zgjedhjeve për shkak të vendndodhjeve të papërshtatshme ose riparimeve të papërfunduara. Sipas KQZ-së, rreth 174,000 zgjedhës u ridrejtuan në një qendër tjetër votimi në ditën e zgjedhjeve.

¹²² Paragrafi 7.4 i vitit [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës](#) të vitit 1990 kërkon që shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së "të garantojnë që votat të hidhen me votim të fshehtë ose me procedurë të barasvlefshme të votimit të lirë".

të aksesueshme në mënyrë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara fizike, kurse në 28 për qind prej tyre, pozicionimi nuk ishte i përshtatshëm për zgjedhës të tillë.¹²³

Autoritetet vendore dhe administrata zgjedhore duhet t'i përforcojnë përpjekjet e tyre për të garantuar aksesueshmërinë e qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar aksesin e tyre të pavarur në procesin zgjedhor.

B. MBYLLJA DHE NUMËRIMI

Mbyllja u vlerësua pozitivisht në të gjitha, përveç 8 nga 100 qendrat e votimit të vëzhguara, me procedura të ndjekura pothuajse në të gjitha rastet. Në tetë raste, MNVZ-ja vuri në dukje se njohja e procedurave nga KQV-të ishte e kufizuar dhe performanca e KQV-së u vlerësua negativisht në pesë raste. Marrja e materialit zgjedhor në 55 nga 58 VNV-të që u vëzhguan nga MNVZ-ja u vlerësua pozitivisht. Procedurat u ndoqën, por në një të pestën e VNV-ve të vëzhguara, u vu re mbipopullim ose vendi i pritjes nuk ishte i përshtatshëm për dërgimin e materialeve.

Numërimi i votave u vëzhgua në 80 VNV. Në rreth 8 për qind të 347 vëzhgimeve, MNVZ-ja e vlerësoi numërimin negativisht. Në shumicën e rasteve, MNVZ-ja vuri re se numërimi ishte i ngadaltë, por profesional dhe metodik, dhe transparenca ishte, ndonjëherë, e kufizuar. MNVZ-ja vërejti gjithashtu mbipopullim dhe, në disa raste, u përball me vështirësi në ndjekjen e procesit të numërimit përmes ekraneve të caktuara me video pasi fletët e votimit nuk shfaqeshin vazhdimisht në kamera. Tensione u raportuan nga pesë VNV, dhe ndërhyrje nga aktivistë partiakë nga dy VNV. Vëzhguesit partiakë ishin të pranishëm pothuajse në të gjitha numërimet e vëzhguara, kurse vëzhguesit e zakonshëm vendas në më shumë se një të tretën.

MNVZ-ja vëzhgoi raste në të cilat grupet e numërimit nuk ndoqën të gjitha procedurat e parashikuara të rakordimit, veçanërisht në rastet kur Procesverbali i Mbylljes së KQV-së nuk gjendej në kutinë e votimit. MNVZ-ja vëzhgoi raste kur ana e pasme e vulosur e fletëve të votimit nuk u ekspozua siç duhet përpara kamerës (28 raportime) dhe raste kur përcaktimi i vlefshmërisë së fletëve të votimit nuk ishte i arsyeshëm ose sipas të njëjtave standarde (përkatesisht gjashtë dhe tetë raportime). Në 27 numërimet të vëzhguara, numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti nuk përputhej me numrin e zgjedhësve që kishin marrë fletë votimi, dhe në 18 numërimet të vëzhguara, numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti nuk ishte i barabartë me shumën e fletëve të vlefshme dhe të pavlefshme të votimit. Në 28 raste u kërkua rinumërim dhe në 2 raste kërkesa për rinumërim u refuzua. MNVZ-ja vëzhgoi 36 raste në të cilat protokollet e rezultateve të votimit duhej të korrigjoheshin. Në 13 vëzhgime, anëtarët e grupeve të numërimit u larguan gjatë numërimit dhe numërimi i votave u ndërpre në 19 raste. MNVZ-ja vërejti se anëtarët e grupeve të numërimit nuk arritën të binin dakord për vlefshmërinë e fletëve të votimit gjatë 13 numërimëve të vëzhguara, kurse në 8 raste vëzhguesit e partive nuk u lejuan të kontestonin vlefshmërinë e fletëve të votimit. Gjithashtu, në 46 raportime thuhej se arsyet e kontestimit të fletëve të votimit nuk ishin pasqyruar siç duhet në anën e pasme të këtyre fletëve votimit. Në 78 vëzhgime, vëzhguesve partiakë nuk u ishin dhënë kopje të protokolleve të rezultateve të votimit. Ndryshe nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, vëzhguesve vendas dhe vëzhguesve ndërkombëtarë nuk iu siguruan protokollet e rezultateve të votimit.

Për të rritur transparencën e procesit zgjedhor dhe për të kontribuar në besimin e publikut, të gjithë vëzhguesit duhet të kenë të drejtën e marrjes së kopjeve të protokolleve të rezultateve të votimit.

Për shkak të ngarkesës së punës dhe lodhjes fizike, grupet e numërimit e ndërprejnë numërimin në shumicën e VNV-ve të vëzhguara, pavarësisht kërkesës ligjore dhe urdhrave të Komisionerit për

¹²³

Në zonat rurale, përqindja e qendrave të votimit të vëzhguara që nuk ishin të aksesueshme në mënyrë të pavarur për personat me aftësi të kufizuara fizike ishte 68 për qind, krahasuar me 53 për qind në zonat urbane.

numërim pa ndërprerje. Në bashkinë e Kurbinit, KQZ-ja e pezulloi numërimin për shkak të tensioneve mes një vëzhguesi partiak dhe një anëtari të grupit të numërimit.

C. TABULIMI DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

Numërimi u përfundua më 17 maj dhe Komisioneri e miratoi tabelën e parë të rezultateve të përgjithshme më 18 maj.¹²⁴ Shumica e rezultateve zgjedhore për garat për kryetarë bashkie u miratua nga KZAZ-të më 16 maj, ndërsa ato për këshillat vendore u vonuan më tej. Tetë kuti votimi u shpallën të parregullta pas vendimeve të KAS-it.¹²⁵ KQZ-ja e nisi publikimin e rezultateve paraprake të votimit për kryetarë bashkie nga qendrat e votimit që ishin pjesë e projektit pilot të votimit elektronik rreth orës 20:40 të ditës së zgjedhjeve dhe rreth orës 23:00 nga bashkitë e tjera, duke kontribuar në transparencë. Të gjitha tabelat përmbledhëse të rezultateve u miratuan nga KQZ-ja brenda datës 26 maj, pas korrigjimit të tabelave të rezultateve të bashkive Elbasan dhe Kamëz, ku ishin evidentuar mospërputhje në disa protokolle.¹²⁶

Deri më 22 maj, KAS-i kishte marrë 11 ankimime ndaj vendimeve të KZAZ-së për miratimin e rezultateve të zgjedhjeve në bashkitë Belsh, Dibër, Kuçovë, Memaliaj, Pukë dhe Tropojë. Më 23 maj, KAS-i e hodhi poshtë ankimimin e partisë Lëvizja e Legalitetit ndaj rezultateve të zgjedhjeve në bashkinë Dibër. Më 26 maj, KAS-i i hodhi poshtë ankimimet e koalicionit Bashkë Fitojmë dhe Partisë Aleanca Demokristiane lidhur me rezultatet e zgjedhjeve përkatësisht në bashkitë Krujë dhe Gjirokastrë. Më 29 maj, KAS-i i rrëzoi edhe ankimimet e Partisë Aleanca Progresiste dhe Partisë Aleanca Demokristiane lidhur me rezultatet e zgjedhjeve përkatësisht në bashkitë Kurbin dhe Kamëz. KAS-i i gjykoj ankimimet në seanca publike, me pjesëmarrjen e palëve në çështje. Vendimet ishin të arsyetuara, duke iu referuar mungesës së provave ose duke konfirmuar ligjshmërinë e proceseve të numërimit.

Pas miratimit të rezultateve të zgjedhjeve në bashkinë Rrogozhinë, më 23 maj, kandidati për kryetar bashkie i koalicionit Bashkë Fitojmë i ankimoi rezultatet në KAS, duke pretenduar manipulime.¹²⁷ Më 6 qershor, KAS-i, me kërkesë të dy anëtarëve të tij, urdhëroi rinumërimin e votave në të gjitha qendrat e votimit në bashki. Si rezultat, diferenca mes kandidatëve të PS-së dhe Bashkë Fitojmë u ul nga 30 në 21 vota.¹²⁸ Koalicioni Bashkë Fitojmë dhe kandidati i tij për kryetar bashkie e ankimuan më tej çështjen në Kolegjin Zgjedhor, i cili më 15 qershor, e anuloi vendimin e KAS-it, i anuloi rezultatet e zgjedhjeve për kryetar bashkie në Rrogozhinë dhe urdhëroi përsëritjen e zgjedhjeve për kryetar bashkie më 23 korrik. Kolegji Zgjedhor e rrëzoi ankimimin e Bashkë Fitojmë në rastin e bashkisë Belsh, ku koalicioni kishte bërë pretendime të ngjashme.

XIV. REKOMANDIME

Këto rekomandime, të përfshira në të gjithë tekstin, ofrohen me synimin përmirësimin e mbajtjes së zgjedhjeve në Shqipëri dhe mbështetjen e përpjekjeve për t'i sjellë ato plotësisht në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike.

¹²⁴ U miratuan rezultatet e para zgjedhore për bashkitë Belsh për kryetar bashkie dhe Rrogozhinë për kryetar bashkie dhe këshillin vendor. Në të dyja bashkitë, anëtarët e KZAZ-së nuk arritën të merrnin një vendim për rezultatet e zgjedhjeve.

¹²⁵ Ndër kutitë e votimit të shpallura të parregullta, dy ishin në KZAZ 27 në Kamëz, një në zgjedhjet për kryetar bashkie në KZAZ 58 (Fier) dhe një për këshillat bashkiakë në secilën nga KZAZ 15 (Kurbin), KZAZ 19 (Dibër) dhe KZAZ 22 (Durrës).

¹²⁶ Rezultatet përfundimtare për këto bashki nuk janë ndikuar nga këto korrigjime.

¹²⁷ Koalicioni Bashkë Fitojmë i ankimoi rezultatet e zgjedhjeve, duke pretenduar se zgjedhësit e regjistruar në qendrën e votimit në burgun e Rrogozhinës nuk kishin të drejtë vote, duke e kundërshtuar vlefshmërinë e listës së zgjedhësve në këtë rast dhe duke pretenduar shkelje në qendra të tjera votimi.

¹²⁸ Shihni [Vendimin e KAS-it nr. 174, të datës 6 qershor](#).

Këto rekomandime duhet të lexohen së bashku me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, të cilat mbeten për t'u adresuar.¹²⁹ ODIHR-i është i gatshëm t'i ndihmojë autoritetet e Shqipërisë për ta përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për të adresuar rekomandimet e përfshira në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

A. REKOMANDIME PARËSORE

1. Organet e zbatimit të ligjit duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të identifikuar dhe hetuar në mënyrë të pavarur të gjitha pretendimet për shkelje zgjedhore, duke përfshirë blerjen e votës, presionin ndaj zgjedhësve dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, në mënyrë tërësore, në kohën e duhur dhe me transparencë. Zgjedhësit duhet të informohen sistematikisht për mekanizmat e zbatueshme për denoncimin e shkeljeve, duke përfshirë mbrojtjen e sinjalizuesve dhe marrjen e masave mbrojtëse ndaj pasojave të denoncimit.
2. Autoritetet duhet të bëjnë përpjekje reale për të rritur ndërgjegjësimin për fenomenin e hershëm të blerjes së votës dhe rreziqet që sjell ajo për integritetin e zgjedhjeve. Denoncimi publik i praktikave të tilla para dhe gjatë fushatës nga aktorët kryesorë, duke përfshirë zyrtarët shtetërorë dhe drejtuesit e partive, mund të shërbejë për frenimin e këtij fenomeni.
3. Për të garantuar fshehtësinë e votës dhe për të parandaluar presionin ndaj zgjedhësve, votimin në grup dhe në vend të personave të tjerë, autoritetet duhet të zbatojnë masa mbrojtëse procedurale efektive.
4. Për të garantuar një kuadër zgjedhor gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, të gjitha subjektet vendimmarrëse, duke përfshirë parlamentin, partitë e tij politike dhe palët e tjera të interesuara zgjedhore, duhet të angazhohen për një reformë zgjedhore kuptimplotë dhe për adresimin e të gjitha rekomandimeve të ODIHR-it.
5. Dispozitat ligjore në lidhje me fushatën, duke përfshirë ato kundër keqpërdorimit të burimeve administrative, duhet të rishikohen për të hequr paqartësitë dhe për të garantuar një garë të barabartë. Autoritetet, duke përfshirë administratën zgjedhore dhe organet e zbatimit të ligjit, duhet t'i trajtojnë të gjithë garuesit në zgjedhje në mënyrë të barabartë.
6. Autoritetet duhet të garantojnë zbatimin e duhur të Ligjit për të Drejtën e Informimit, të dekriminalizojnë shpifjen dhe të mbështesin gazetarinë e pavarur.
7. Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe për të garantuar qëndrueshmërinë e administratës zgjedhore, duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të sistemit të emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të administratës zgjedhore të nivelit të ulët. Duhet të merren masa për të ndaluar zëvendësimet arbitrare të anëtarëve të administratës zgjedhore.
8. Përdorimi nga media i materialeve të prodhuara nga partitë ose autoritetet shtetërore në programet e lajmeve dhe informacionit duhet të shmanget ose të kufizohet në raste të jashtëzakonshme, veçanërisht gjatë fushatave zgjedhore. Sa herë që transmetohen materiale të

¹²⁹ Sipas paragrafit 25 të [Dokumentit të OSBE-së të Stambollit të vitit 1999](#), shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u zotuan "të ndjekin pa vonesa vlerësimin dhe rekomandimet e zgjedhjeve të ODIHR-it". Ndjekja e rekomandimeve të mëparshme është vlerësuar nga ODIHR-i si më poshtë: rekomandimi 18 nga [raporti përfundimtar për zgjedhjet vendore të vitit 2019](#) (Raporti përfundimtar i vitit 2019) dhe rekomandimet 6 dhe 8 nga [raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021](#) (Raporti përfundimtar i vitit 2021) janë zbatuar plotësisht. Rekomandimet 5, 6, 8, 11 dhe 14 nga raporti përfundimtar i vitit 2019 dhe rekomandimet 7 dhe 21 nga raporti përfundimtar i vitit 2021 janë zbatuar kryesisht. Rekomandimet 1-4, 7, 12, 13 15 dhe 20 nga raporti përfundimtar i vitit 2019 dhe rekomandimet 2, 3, 9, 10, 16, 19 dhe 23 nga raporti përfundimtar i vitit 2021 janë zbatuar pjesërisht. Shihni gjithashtu [Bazën e të dhënave të rekomandimeve zgjedhore të ODIHR-it](#).

tilla, duhet të identifikohen qartësisht si përmbajtje e prodhuar nga garuesit politikë siç kërkohet me ligj. Për shkeljet që lidhen me kërkesat e ligjit për identifikimin e këtyre materialeve të gatshme duhet të parashikohen sanksione dhe duhet të zbatohen.

B. REKOMANDIME TË TJERA

Kuadri ligjor

9. Aktet nënligjore që rregullojnë procesin zgjedhor duhet të miratohen në kohën e duhur për të garantuar siguri juridike, përgatitje efektive dhe njohjen e tyre nga publiku.

Administrata zgjedhore

10. Administrata zgjedhore, partitë politike dhe shoqëria civile duhet të përpiqen t'i përmirësojnë më tej programet për edukimin e zgjedhësve, veçanërisht në nivel qarku. Mund t'i kushtohet vëmendje përshtatjes së iniciativave për nevojat e pakicave kombëtare, veçanërisht romëve dhe egjiptianëve, dhe zgjedhësve me aftësi të kufizuara.
11. Për të rritur transparencën dhe besimin e publikut, burime të mjaftueshme duhet të shpërndahen paraprakisht për të garantuar përgatitje efektive dhe monitorim të pavarur dhe kuptimplotë nga publiku të teknologjive zgjedhore.
12. Autoritetet duhet t'i njohin më mirë zgjedhësit me teknologjitë zgjedhore dhe të ofrojnë akses të barabartë në procesin e votimit. Duhet të merren masa për t'u mundësuar zgjedhësve që përdorin teknologji të reja të votojnë në mënyrë të pavarur dhe në fshehtësi të plotë.
13. Autoritetet vendore dhe administrata zgjedhore duhet t'i përforcojnë përpjekjet për garantimin e aksesueshmërisë së qendrave të votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe për të përmirësuar aksesin e tyre të pavarur në procesin zgjedhor.

Regjistrimi i zgjedhësve

14. Për të garantuar të drejtën universale të votës dhe trajtim të barabartë përpara ligjit, kufizimet e bazuara në aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale duhet të hiqen.
15. Autoritetet duhet t'i informojnë të gjithë zgjedhësit për vendndodhjen e qendrave të tyre përkatëse të votimit dhe t'i afishojnë vazhdimisht listat e zgjedhësve në të gjitha bashkitë. Duhet të merret parasysh zhvendosja e afatit për njoftimin e zgjedhësve më afër ditës së zgjedhjeve.
16. Mund t'i kushtohet vëmendje rekrutimit dhe trajnimit të operatorëve teknikë përgjegjës për identifikimin elektronik të zgjedhësve në kohën e duhur. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të shohë mundësinë e kryerjes së një auditimi të pavarur të pajisjeve dhe softuerit përpara ditës së zgjedhjeve.

Regjistrimi i kandidatëve

17. Duhet të hiqen kufizimet e të drejtës së kandidimit të personave, fajësia e të cilëve për kryerjen e një vepre penale nuk është provuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
18. Duhet t'i kushtohet vëmendje rishikimit të pragut për mbështetjen e zgjedhësve për të garantuar të njëjtat kushte të zbatueshme për kandidatët e pavarur dhe atyre të propozuar nga partitë.

19. Për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të grave në jetën publike dhe politike, duke përfshirë zgjedhjet për kryebashkiakë, autoritetet në të gjitha nivelet duhet të ndërmarrin përpjekje gjithëpërfshirëse ligjore, institucionale dhe edukative për të kapërcyer stereotipet gjinore ekzistuese. Partitë politike duhet të identifikojnë dhe kufizojnë çdo pengesë të mundshme me bazë gjinore për kandidatet gra, duke përfshirë rishikimin e praktikave aktuale brenda partive që e pengojnë përfaqësimin më efektiv të grave brenda strukturave partiake dhe si candidate.

Financimi i fushatës

20. Vendimet për ndarjen dhe transferimin e fondeve publike për partitë politike përfituese duhet të merren në kohën e duhur për të garantuar akses efektiv në këto fonde për qëllime të fushatës. Mund t'i kushtohet vëmendje zgjerimit të financimit publik të fushatës për kandidatët e pavarur.
21. Për të rritur transparencën, duhet të ketë publikime periodike të kontributeve financiare dhe shpenzimeve për fushatë përpara ditës së zgjedhjeve.

Media

22. Autoritetet shtetërore duhet të promovojnë një mjedis mediatik të pavarur dhe vërtet të larmishëm, pa ndikime nga politika dhe biznesi. Parlamenti duhet ta ndryshojë Ligjin për mediat audiovizive për të kufizuar përqendrimin e pronësisë së mediave në sektorin e transmetimit dhe të paraqesë masa për të parandaluar ndikimin e padrejtë të pronarëve të mediave mbi politikën editoriale.
23. Rregullat e Kodit Zgjedhor për ndarjen e kohës së transmetimit për garuesit zgjedhorë duhet të ndryshohen për të reduktuar avantazhin e partive kryesore parlamentare në programet editoriale dhe për të garantuar një ndarje më të drejtë të kohës për të gjitha partitë garuese.
24. Autoriteti i Mediave Audiovizive duhet të pajiset me burime të mjaftueshme materiale dhe teknike për të rritur kapacitetin e tij monitorues dhe raportues të medias.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve zgjedhore

25. Për të garantuar sigurinë juridike dhe një zgjidhje juridike efektive, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve duhet të sigurojë një vendimmarrje uniforme, duke shmangur arsyetimet ligjore të paqëndrueshme.
26. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe ankimimet në kohën e duhur dhe të jetë i përgatitur siç duhet dhe të ketë burimet për ta bërë këtë. Për të garantuar transparencë, të gjitha vendimet për mosmarrëveshjet zgjedhore duhet të publikohen menjëherë dhe të jenë të aksesueshme për të gjithë.

Vëzhgimi i zgjedhjeve

27. Për të rritur transparencën e procesit zgjedhor dhe për të kontribuar në besimin e publikut, të gjithë vëzhguesit duhet të kenë të drejtën e marrjes së kopjeve të protokolleve të rezultateve të votimit.

SHTOJCA I: REZULTATET E ZGJEDHJEVE¹³⁰

Rezultatet e zgjedhjeve për kryetarët e bashkive

Numri i zgjedhësve të regjistruar	3,650,658	%
Numri i zgjedhësve që votuan	1,395,627	38.23
Numri i votave të vlefshme për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive	1,352,330	
Numri i votave të pavlefshme për zgjedhjen e kryetarëve të bashkive	43,148	3.09
Numri i votave të vlefshme për zgjedhjen e këshillave bashkiakë	1,344,468	
Numri i votave të pavlefshme për zgjedhjen e këshillave bashkiakë	50,613	3.63

Subjekti zgjedhor	Mandatet e kryebashkiakëve
Partia Socialiste e Shqipërisë	52
Koalicioni Bashkë Fitojmë	7
Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	1

Rezultatet e zgjedhjeve për këshillat bashkiakë

Subjekti zgjedhor	Votat e marra		Mandate
	Në numër	Në përqindje	
Partia Socialiste e Shqipërisë	579,614	43.11	758
Koalicioni Bashkë Fitojmë	247,880	18.44	292
Partia Demokratike	103,719	7.71	123
Partia Socialdemokrate	86,281	6.42	116
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	44,047	3.28	52
Partia Republikane e Shqipërisë	32,070	2.39	34
Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	28,977	2.16	25
Partia Lëvizja e Legalitetit	23,683	1.76	21
Partia e Gjelbër	16,326	1.21	20
Partia Aleanca Progresiste	22,906	1.70	19
Partia Demokracia Sociale	21,798	1.62	18
Aleanca Arbnore Kombëtare	11,680	0.87	18
Fryma e Re Demokratike	18,458	1.37	17
Koalicioni “Aleanca Liberale e Djathtë”	16,858	1.25	13
Aleanca Demokratike Shqiptare	6,129	0.46	10
Ardhmëria Shqiptare	6,963	0.52	8
Partia Demokristiane	6,211	0.46	8

Subjekti zgjedhor	Votat e marra		Mandate
	Në numër	Në përqindje	
Partia Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	2,275	0.17	8
Kandidatët e pavarur	7,165	0.53	7
Nisma Thurje	10,804	0.80	5
Partia Balli Kombëtar	7,611	0.57	5
Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	6,373	0.47	5
Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	4,647	0.35	5
Partia Uniteti Kombëtar	5,592	0.42	4
Bindja Demokratike	4,226	0.31	4
Partia Kombëtare Konservatore e Shqipërisë	1,881	0.14	4
Aleanca e Maqedonasve për Integrim Evropian	439	0.03	3
Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	1,383	0.1	2
Lëvizja Punëtore Shqiptare	546	0.04	2
Lëvizja Bashkë	7,539	0.56	1
Partia Konservatore	2,767	0.21	1
Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Evropiane	1,125	0.08	1
Lëvizja e Re	966	0.07	1
Partia Komuniste e Shqipërisë	914	0.07	1
Partia për Mbrojtjen e të Drejtave të Emigrantëve	886	0.07	1
Fronti i majtë	270	0.02	1

SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesVE TË MISIONIT NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE

Ekipi bazë i MVZ-së së ODIHR-it

Ambasadorja Audrey Glover	Shefe e Misionit	Mbretëria e Bashkuar
Armen Mazmanyan		Armeni
Davor Čorluka		Bosnje-Hercegovinë
Desislava Hristova		Bullgari
Stefan Krause		Gjermani
Giovanna Maiola		Itali
Jurga Lukšaitė		Lituani
Rokas Stabingis		Lituani
Roman Railean		Moldavi
Slaviša Kotlaja		Mal i Zi
Tomasz Jańczy		Poloni
Ružica Jovanović		Serbi
Saša Pokrajac		Serbi
Ivan Godársky		Slllovakia
Anders Eriksson		Suedi
Kyle Bowers		Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it

Adnan Habul	Bosnjë-Hercegovinë
Michael Walker	Kanada
Pavlina Öhman	Republika Çeke
Valdemar Uruba	Republika Çeke
Niels Boel	Danimarkë
Sampsa Lauerma	Finlandë
Marion Jouannet	Francë
Christel Thibault	Francë
David Buerstedde	Gjermani
Claudia Schwfer	Gjermani
Eleni Ioannou	Greqi
Nicholas Yiannias	Greqi
Bernard Daly	Irlandë
Lucrezia Aresi	Itali
Filippo Ristoldo	Itali
Tove Gravdal	Norvegji
Ana Mihajlović	Serbi
Nina Genneby	Suedi
Lars Tollemark	Suedi
Barbara Egger Maldonado	Zvicër
Martin Minder	Zvicër
David Ballard	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Raleigh Quesenberry	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Elia Varela-Serra	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatshkurtër të MVZ-së së ODIHR-it

Gertrude Brindlmayer	Austri
Anja Fiedler	Austri
Hermann Hagspiel	Austri
Bernhard Zimburg	Austri
Anela Cavdar	Bosnje-Hercegovinë
Mubera Vulović	Bosnje-Hercegovinë
Maria Ghazzaoui	Kanada
Claude Larocque	Kanada
David Milne	Kanada

Meghan Riley	Kanada
Martha Sellu	Kanada
Pavel Hanosek	Republika Çeke
Ondrej Picka	Republika Çeke
Petra Schmiedova	Republika Çeke
Kirsten Andersen	Danimarkë
Dorte Broen	Danimarkë
Ib Kok Hansen	Danimarkë
Mette Grumløse Hjelmso	Danimarkë
Jorgen Hoxer	Danimarkë
Erik Nielsen	Danimarkë
Karen Skipper	Danimarkë
Bjarno Soerensen	Danimarkë
Sofia Svensson	Danimarkë
Nele Hollo	Estoni
Jari Huuhtanen	Finlandë
Eva Kajan	Finlandë
Mikko Niiles	Finlandë
Noora Simola	Finlandë
Charlotte Barthelot de Bellefonds	Francë
Alexandre Benz	Francë
Nadia Jurzac	Francë
Arthur Langlois	Francë
Pascale Le Hel	Francë
Alexiei Ozeretzkovsky	Francë
Jasmine Salhab	Francë
Marion Van der Pyl Lenne	Francë
Anja Bronny	Gjermani
Birgit Daiber	Gjermani
Tina Debenham	Gjermani
Isabella Gabriel	Gjermani
Luiz Garcia Pereira Ramalho	Gjermani
Dorothee Georg	Gjermani
Harald Happel	Gjermani
Jochen Hayungs	Gjermani
Martin Herrmann	Gjermani
Henning Horstmeyer	Gjermani
Christiane Jaenicke	Gjermani
Helmut Klaëonn	Gjermani
Timo Knaebe	Gjermani
Martin Kobler	Gjermani
Peter Kohlmeier	Gjermani
Brigitte Krech	Gjermani
Stefan Lesjak	Gjermani
Edeltraud Lier	Gjermani
Alexander Loch	Gjermani
Elena Lopez Werner	Gjermani
Martin Nölle	Gjermani
Brigitte Schmid	Gjermani
Tillmann Schneider	Gjermani
Ulrich Seel	Gjermani
Heidrun Smers	Gjermani
Barbara Staib	Gjermani
Anca Stan	Gjermani
Arnim Stauth	Gjermani
Evelyn Stöckle	Gjermani
Barbara Wägerle	Gjermani

Janette Colgan	Irlandë
Michael Gannon	Irlandë
Fidelma Healy Eames	Irlandë
Rossana Mamberto	Itali
Paolo Pagotto	Itali
Gilberto Pelosi	Itali
Rossella Pizzera	Itali
Daniele Sferra	Itali
Monica Simeone	Itali
Sirbu Rodica	Moldavi
Miloš Nikolić	Mal i Zi
Nazim Rechi	Maqedoni e Veriut
Inger Bakken	Norvegji
Alida Boye	Norvegji
Bjørn Heger	Norvegji
Rolf Ranheim	Norvegji
Sven Gunnar Simonsen	Norvegji
Joana Pereira	Portugali
Emanuela Darie	Rumani
Alice Minculescu	Rumani
Catalina Niculae	Rumani
Stefan Rantzos	Rumani
Aleksandra Radosavljević	Serbi
Sergio Barrera	Spanjë
Esther Beceiro Garcia	Spanjë
Javier Martin Cantera	Spanjë
Maria Romero Pardo	Spanjë
Linda Cederblad	Suedi
Mats Ekholm	Suedi
Carl Johan Ekstedt	Suedi
Stig Lennart Glans	Suedi
Åke Lennart Haggren	Suedi
Anna Birgitta Jacobson	Suedi
Inger Elisabeth Johansson	Suedi
Dalia Lahdo	Suedi
Stina Elisabet Larserud	Suedi
Sara Lindblom	Suedi
Andre Nilen	Suedi
Håkan Per-Olov Nyman	Suedi
Helena Olsson	Suedi
Maja Trille Permerup	Suedi
Lisa Kristina Petri	Suedi
Jan Roland Pettersson	Suedi
Inga Kerstin Sundberg	Suedi
Bo Pontus Tallberg	Suedi
Fairlie Chappuis Jensen	Zvicër
Diana Ferrari	Zvicër
Michelle Gysin	Zvicër
Magali Mores	Zvicër
Valerie Nadrai	Zvicër
Hans-Peter Portmann	Zvicër
Gianluca Rigolio	Zvicër
Nadia Simoes	Zvicër
Lena Studer	Zvicër
Lee Bauer	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kelly Beadle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Daniel Brezina	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Carolyn Brommer	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jennifer Butz	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Gina Chirillo	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Tracey Cobb	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Aiesha Eleusizov	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jeffrey Erlich	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Naida Filipovic	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert Frost	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Doris Garcia-Smith	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Rebecca Graham	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert Hampshire	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Barron Helgoe	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Robert Irish	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Junie Joseph	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Emily Koo	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Micah Lebson	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Eric Manton	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Alexander Mayer	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
William McGregor	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Auset Mitchell	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Brooke Nagle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Danny Navarro	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Steven Nothern	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Urania Petit	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Constance Phlipot	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Mitchell Polman	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Sarah Prunier-Duparge	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Karen Reinhardt	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kevin Rejent	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Emily Rome	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Thomas Rome	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Michael Sawyer	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Melody Shekari	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Laura Sherman	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Steven Smith	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Marilyn Stempler	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Logan Trombley	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Rene Valdiosera	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Cara Vetsch	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Annisa Wanat	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Henry Wathen	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Susanna Zaraysky	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës

Stewart Dickson	Kreu i Delegacionit	Mbretëria e Bashkuar
Jana Fischerova		Republika Çeke
Kirsten Andersen		Danimarkë
Ott Kasuri		Estoni
Tanja Joon		Finlandë
Markku Suski		Finlandë
Xavier Cadoret		Francë
Mathilde Girardi		Francë
Svitlana Pereverten		Francë
Martine Roudolff		Francë
Sevdia Ugrekhelidze		Gjeorgji
Konstantinos Koukas		Greqi
James Moloney		Irlandë

Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës

Belinda Gottardi	Itali
Alexander Boomgaars	Holandë
Joao Manuel Esteves	Portugali
Matija Kovac	Serbi
Ana Gonzalez Rodriguez	Spanjë
Kristoffer Tamsons	Suedi
Marie Thomet	Zvicër

Parlamenti Evropian

Sven Simon	Kreu i Delegacionit	Gjermani
Blagoy Klimov	DPE	Bullgari
Anna Ksiazczakova	DPE	Republika Çeke
Patricia Chagnon	DPE	Francë
Lars Patrick Berg	DPE	Gjermani
Tobias Teuscher	DPE	Gjermani
Nikos Papandreou	DPE	Greqi
Raffaele Luise	DPE	Itali
Francesco Miatto	DPE	Itali
Wojciech Sperzynski	DPE	Poloni

RRETH ODIHR-IT

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së për të ndihmuar Shtetet pjesëmarrëse "për të garantuar respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për t'iu bindur sundimit të ligjit, për të promovuar parimet e demokracisë dhe (...) për të ndërtuar, për të forcuar dhe për të mbrojtur institucionet demokratike, si dhe për të promovuar tolerancën në të gjithë shoqërinë "(Dokumenti i Samitit të Helsinkit 1992). Ky njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

ODIHR-i, me qendër në Varshavë (Poloni) është krijuar si Zyra për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit të vitit 1990 dhe ka filluar të funksionojë në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat të zgjeruar, që përfshinte edhe të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot, kjo zyrë punëson mbi 150 vetë.

ODIHR-i është agjencia kryesore në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Çdo vit, ai koordinon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar nëse zgjedhjet në rajonin e OSBE-së kryhen në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin kombëtar. Metodologjia e tij unike ofron një njohje të thellë të procesit zgjedhor në tërësinë e tij. Përmes projekteve të asistencës, ODIHR-i ndihmon shtetet pjesëmarrëse për të përmirësuar kuadrin e tyre ligjor.

Aktivitetet e **demokratizimit të** Zyrës përfshijnë: sundimin e ligjit, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, migracionin dhe lirinë e lëvizjes, dhe barazinë gjinore. ODIHR-i zbaton çdo vit një sërë programesh asistence, në përpjekje për të zhvilluar struktura demokratike.

ODIHR-i gjithashtu ndihmon shtetet pjesëmarrëse 'në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të promovuar dhe mbrojtur **të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në** përputhje me angazhimet dhe dimensionin njerëzor të OSBE-së. Kjo arrihet duke punuar me një shumëllojshmëri partnerësh për të nxitur bashkëpunimin, për të ndërtuar kapacitete dhe për të siguruar ekspertizë në fusha tematike, duke përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, duke rritur mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin mbi të drejtat e njeriut, monitorimin e të drejtave të njeriut dhe raportimin, dhe të drejtat e njeriut dhe sigurinë e grave.

Brenda fushës së **tolerancës** dhe **mosdiskriminimit**, ODIHR-i siguron mbështetje për shtetet pjesëmarrëse në forcimin e reagimit të tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mungesës së tolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it në lidhje me tolerancën dhe mosdiskriminimin përqendrohen në fushat e mëposhtme: legjislacioni; trajnimi për zbatimin e ligjit; monitorimi, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja; si dhe aktivitete arsimore për të promovuar tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

ODIHR-i ofron këshilla për shtetet pjesëmarrëse në lidhje me politikat e tyre për **romët dhe sintit**. Ai promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin midis komuniteteve rome dhe sinti dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të romëve dhe sintive në organet politikëbërëse.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it kryhen në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet e OSBE-së dhe operacionet në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më shumë informacion gjendet në faqen e internetit të ODIHR-it (www.osce.org/odihrite (www.osce.org/odihr)).